

Raport Nr. INSP/R2008-0004/2

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim

**RAPORT DHE REKOMANDIM I GRUPIT TË MENAXHERËVE
NË PËRGJIGJE TË
RAPORTIT TË INVESTIGIMIT TË PANELIT TË INSPEKTIMIT**

SHQIPËRIA

**PROJEKTI PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR DHE PASTRIMIN E ZONËS
BREGDETARE (KREDI NGA SHNZH NR 4083-ALB)**

18 SHKURT 2009

**RAPORT DHE REKOMANDIM I GRUPIT TË MENAXHERËVE NË
PËRGJIGJE TË RAPORTIT TË INVESTIGIMIT TË PANELIT TË
INSPEKTIMIT
NË LIDHJE ME
SHQIPËRIA: PROJEKTI PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR DHE
PASTRIMIN E ZONËS BREGDETARE (KREDI NGA SHNZH NR 4083-ALB)**

Në mbështetje të paragrafit 23 të Rezolutës që krijon Panelin e Inspektimit (Rezoluta e BNRZH-së Nr 93-10 dhe Rezoluta e SHNZH-së Nr 93-6), bashkëlidhur, i paraqitet për shqyrtim Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë “Raporti dhe Rekomandimi” i Grupit të Menaxherëve, në përgjigje të konstatimeve të parashtruara në Raportin e Investigimit Nr 46596-AL, i datës 24 nëntor 2008, i Panelit të Inspektimit, në lidhje me projektin e cituar në titull (Shqipëria: Projekti për Menaxhimin e Integruar dhe Pastrimin e Zonës Bregdetare (Kredi nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim Nr 4083-ALB)).

**RAPORT DHE REKOMANDIM I GRUPIT TË MENAXHERËVE
NË PËRGJIGJE TË
RAPORTIT TË INVESTIGIMIT TË PANELIT TË INSPEKTIMIT, NR 46596-AL**

**SHQIPËRIA
PROJEKTI PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR DHE PASTRIMIN E ZONËS
BREGDETARE (KREDI NGA SHNZH NR 4083-ALB)**

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
I. HYRJE	5
II. KONTEKSTI I PROJEKTIT.....	6
III. STATUSI I PROJEKTIT	11
IV. ÇËSHTJET KRYESORE.....	14
V. MËSIMET E NXJERRA.....	26
VI. PLANI I VEPRIMEVE I GRUPIT TË MENAXHERËVE	30
VII. PËRFUNDIM	33

Anekset

- Aneksi 1: Plani i Zhvillimit të Bregdetit të Jugut
Aneksi 2: Konstatime, komente dhe veprime

Harta

- Harta 1. IBRD 36691

SHKURTIME

ALUIZNI	Agjencia për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave dhe Ndërtesave Informale, pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
PB	procedurat e bankës
EAQ	nën/presidenca për Evropën dhe Azinë Qendrore
ESSF	kuadri i masave mbrojtëse mjedisore dhe sociale
BE	Bashkimi Evropian
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
MIZB	Menaxhimi i Integruar i Zonës Bregdetare
PMIPZB	Projekti për Menaxhimin e Integruar dhe Pastrimin e Zonës Bregdetare
SHNZH	Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim
PIN	Paneli i Inspektimit
ISDS	fleta me të dhënat për masat mbrojtëse të integruara
RSZ	raporti mbi statusin e zbatimit
LEG	nën/presidenca për çështjet juridike
MPPTT	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
MM	Marrëveshje Mirëkuptimi
DMP	Deklarata e Manualit të Punës
PO	politikë operative
POSHV	nën/presidenca për politikat operative dhe shërbimet për vendin
DVP	dokument i vlerësimit të projektit
PZHBJ	Plani i Zhvillimit të Bregdetit të Jugut
UNECE	Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara

LISTA E POLITIKAVE OPERATIVE DHE DEKLARATAVE TË MANUALEVE TË PUNËS

PO/PB 1.00	Ulja e Varfërisë
PO/PB 4.12	Shpërngulja e Detyruar
DMP 2.20	Vlerësimi i Projekteve
PO/PB 10.00	Huadhënia për Investime: nga Identifikimi deri në Paraqitjen për Bordin
PO/PB 13.05	Mbikëqyrja e Projekteve

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Informacion i shkurtër shpjegues

Shqipëria doli nga epoka e komunizmit në fillim të viteve '90, si një prej vendeve më të varfra të Evropës, me shumë pak burime për t'i dhënë shtytje zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Njëra prej pasurive më të rëndësishme mjedisore dhe ekonomike të saj është bregdeti mesdhetar, sidomos bregdeti i jugut, që është i shkëlqyer sa i takon trashëgimisë së pasur kulturore, bukurisë natyrore dhe shumëllojshmërisë së florës dhe faunës. Turizmi ofron mundësi të rëndësishme, siç e tregojnë edhe shifrat e vitit 2007, ku 14 për qind e PBB-së dhe 11 për qind e vendeve të punës vinin nga turizmi.

Sot, kjo vijë bregdetare, 168 kilometra e gjatë, ndodhet nën kërcënimin e zhdukjes për shkak të ndërtimeve të parregulluara, infrastrukturës joadekuate, mosmbledhjes së mbetjeve të ngurta dhe mostrajtit të ujërave të zeza, si edhe për shkak të trysnisë në rritje që ushtrohet mbi zonat e mbrojtura. Në fillim të vitit 2004, Qeveria e Shqipërisë i kërkoi Bankës Botërore ta mbështeste për projektimin e një kuadri, i cili do t'i jepte mundësi vendit ta zhvillonte bregdetin në mënyrë të qëndrueshme.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Banka Botërore punoi me autoritetet shqiptare për të ngritur Projektin për Menaxhimin e Integruar dhe Pastrimin e Zonës Bregdetare (“Projekti”), me synim mbrojtjen e burimeve dhe pasurive kulturore të bregdetit, së bashku me nxitjen e përdorimit të tokës në mënyrë të qëndrueshme, pjesëmarrjes së komunitetit dhe përmirësimit të kushteve mjedisore. Projekti u miratua më 21 qershor 2005.

Çështjet përpara Panelit të Inspektimit

Në muajin prill 2007, në bashkësinë Jalë të bregdetit jugor të Shqipërisë, u prishën tërësisht ose pjesërisht 15 ndërtesa, për shkak të gabimeve në zbatim të Projektit. Deri tani, familjeve të prekura nuk u është dhënë asnjë asistencë. Qeveria dhe familjet nuk janë të një mendjeje, sa i takon ligjshmërisë së prishjes së objekteve.

Grupi i Menaxherëve ndjen keqardhje të thellë për këto ngjarje. Janë bërë një sërë gabimesh gjatë gjithë ciklit të Projektit, përfshirë fazat e përgatitjes së Projektit, paraqitjes përpara Bordit dhe mbikëqyrjes së Projektit, si edhe gjatë përgatitjes së Përgjigjes së parë të Grupit të Menaxherëve, në shtator 2007, dhe gjatë nxjerrjes së Ndrejjes së Gabimeve në Dokumentin e Vlerësimit të Projektit, në shtator 2008. Këto gabime janë të papranueshme dhe nxjerrin në pah një mosfunksionim të rëndë të mekanizmave të llogaridhënies, përgjegjësisë dhe kontrollit mbikëqyrës që ushtron mbi Projektin Grupi i Menaxherëve. Grupi i Menaxherëve i është mirënjohëse Panelit të Inspektimit, për faktin që ia ka sjellë në vëmendje këto gabime, dhe pajtohet me Panelin se janë shkelur PO/PB 10.00 “Për huadhënien për investime—nga identifikimi deri në paraqitjen përpara Bordit” dhe PO/PB 13.05 “Për mbikëqyrjen e projekteve”.

Sa i takon Politikës Operative “Për shpërnguljen e detyrueshme” (PO/PB 4.12), Paneli i Inspektimit konstatoi se kjo politikë duhej të ishte aplikuar për përgatitjen e komponentit “Plani i Zhvillimit i Bregdetit Jugor (PZHBJ)” të Projektit dhe për programin e Qeverisë, në zbatim e sipër, për prishjen e objekteve. Në kohën kur i është

paraqitur Projekti Bordit, Grupi i Menaxherëve vlerësonte se kjo politikë nuk aplikohet për veprimtaritë e planifikimit të përdorimit të tokës, siç ishte PZHBJ. Grupi i Menaxherëve e pranon se dispozitat përkatëse të kësaj politike janë të paqarta dhe, si të tilla, kërkojnë qartësim. Grupi i Menaxherëve do ta shqyrtojë aplikimin e politikave mbrojtëse në projektet që mbështesin planifikimin e përdorimit të tokës dhe do të nxjerrë udhëzues për të trajtuar çështjet mjedisore dhe sociale.

Grupi i Menaxherëve e pranon se prishja e objekteve në Jalë i ka prekur negativisht Kërkuesit. Grupi i Menaxherëve është dakord se këto ngjarje kanë krijuar një situatë, në të cilën palëve të prekura u duhet dhënë asistencë.

Mësimet e nxjerra

Në Raportin e Grupit të Menaxherëve renditet një gamë mësimesh të nxjerra. Projektet komplekse kërkojnë ekipe të drejtimit të projektit që të kenë përvojë dhe një gamë të gjerë aftësish teknike, si edhe të jenë nën kontrollin mbikëqyrës të Grupit të Menaxherëve që të jetë intensiv dhe i vazhdueshëm. Rreziqet dhe masat për zbutjen e tyre lipset të trajtohen tërësisht dhe të paraqiten plotësisht dhe sinqerisht në dokumentet e projekteve. Sidomos, u duhet kushtuar vëmendja e mjaftueshme rreziqeve sociale. Gjatë përpilimit të projekteve komplekse të planifikimit të përdorimit të tokës, është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje kuadrit ligjor dhe institucional. Përgatitja për mbledhjet e Bordit duhet të jetë e hollësishme, duhen pranuar menjëherë gabimet dhe duhen trajtuar me shpejtësi problemet e pazgjidhura pas mbledhjes së Bordit.

Puna për të ardhmen

Qysh prej mesit të vitit 2008, Grupi i Menaxherëve dhe Qeveria e Shqipërisë kanë zhvilluar bisedime së bashku për një kuadër të masave për të përmirësuar vënien në zbatim të Projektit, përfshirë një ndalim të përkohshëm të prishjes së ndërtimeve ekzistuese në zonën e Projektit deri në plotësimin e kushteve specifike. Grupi i Menaxherëve i njuh dhe i vlerëson përpjekjet e Qeverisë së Shqipërisë për të mbyllur elementet e parashtruar më lart. Mirëpo, Qeveria e Shqipërisë e ka informuar Grupin e Menaxherëve se nuk është e gatshme, për momentin, të bëjë shtesa dhe ndryshime në Marrëveshjen e Kredisë, për të pasqyruar pezullimin e prishjes së ndërtimeve ekzistuese, hap, të cilin Grupi i Menaxherëve e konsideron thelbësor për të siguruar që Projekti të ketë një bazë ligjore të shëndoshë për vënien në zbatim me sukses të tij. Në mungesë të një ndryshimi të tillë, që do të ishte i nevojshëm për t'u kujdesur që Projekti të mund të realizohet në përputhje me objektivat zhvillimor të deklaruar, më 9 janar 2009 Projekti është pezulluar.

Megjithatë, Qeveria e Shqipëria ka rënë dakord sa më poshtë: (a) asistencë për ata Kërkues që janë të varfër dhe/ose në pozita të cënueshme; (b) një shqyrtim në kohë, të pavarur, të monitoruar e rast pas rasti në sistemin gjyqësor shqiptar, të pretendimeve të Kërkuesve, ku thonë se kanë pësuar dëme si rezultat i prishjes së objekteve në prill 2007 dhe se duhet të kompensohen si rezultat i prishjes së këtyre objekteve; dhe (c) Banka Botërore të financojë vëzhguesin e pavarur dhe shërbimet juridike që u nevojiten Kërkuesve. Banka do të konfirmojë garancinë e Qeverisë se do të bëhen të gjitha përpjekjet e mundshme për përfundimin e përsheptuar të këtij shqyrtimi gjyqësor, duke njohur, në të njëjtën kohë, dhe duke angazhuar për të respektuar tërësisht pavarësinë e

gjyqësorit. Banka do të konfirmojë edhe që Qeveria do të ofrojë të gjithë dokumentacionin që ka në dispozicion, të nevojshëm për shqyrtimin gjyqësor, dhe që Qeveria nuk do të ketë kundërshtim për një propozim të arsyeshëm për bashkimin në një çështje të padive të Kërkuesve. Më tej, Banka do të konfirmojë edhe që Qeveria do të respektojë dhe do të përmbushë menjëherë të gjithë vendimet e gjykatës, të dala nga procesi i shqyrtimit gjyqësor, përfshirë edhe çdo vendim për t'i dëmshpërblyer paditësit. Nëse procesi gjykohej si i pakënaqshëm nga vëzhguesi i pavarur apo nga Banka, Grupi i Menaxherëve rezervon opsionin (i) t'i pezullojë lëvrimet e fondeve në kuadër të Projektit të ristrukturuar, nëse hiqet pezullimi i tanishëm dhe ristrukturohet Projekti; dhe (ii) pavarësisht vendimit për ta anuluar apo ristrukturuar Projektin (shih më poshtë), t'u ofrojë asistencë Kërkuesve, edhe pse Banka nuk ka detyrimin ligjor për ta bërë një gjë të tillë.

Projekti mbetet i pezulluar, deri në arritjen e një vendimi për njërin prej dy opsioneve. Opsioni 1 konsiston në anulimin nga ana e Grupit të Menaxherëve, të gjithë Kredisë së SHNZH-së; Opsioni 2 propozon që, në bashkërendim me donatorët e tjerë, të ristrukturohet Projekti për të ruajtur mbështetjen për aktivitetet e mëposhtme: (i) pastrimi i mbetjeve të rrezikshme në Porto-Romano; (ii) ndërtimi i një vend-groposje plehrash (*landfill*) dhe përgatitja e një sistemi të administrimit të mbetjeve të ngurta; (iii) ndërtimi i një terminali të udhëtarëve në Portin e Sarandës; (iv) investime në shkallë të vogël në ujësjellës-kanalizime në qytetin e Sarandës dhe në fshatrat e vegjël të Bregdetit të Jugut; (v) investime me bazë komunitetin në fshatrat bregdetare; dhe (vi) administrimi i zonave të mbrojtura të Parkut Kombëtar të Butrintit. Duke pasur parasysh se nuk është arritur një marrëveshje në lidhje me pezullimin e prishjes së ndërtimeve ekzistuese, që do të pasqyrohej në një Marrëveshje ligjore të ndryshuar, të gjitha aktivitetet e rregullimit të territorit do të anuloheshin dhe fondet për to do t'u shpërndaheshin aktiviteteve të tjera. Nëse do të ristrukturohej Projekti, pezullimi i lëvrimet të fondeve do të hiqej për të gjitha veprimtaritë me përjashtim të atyre të rregullimit të territorit, për të siguruar vijimin e zbatimit të investimeve të rëndësishme në infrastrukturë.

Grupi i Menaxherëve të Lartë të Bankës Botërore ka realizuar një shqyrtim brenda Bankës, për 1.550 projektet e portofolit të saj, si edhe kuadrin organizativ për kontrollin e cilësisë në të gjitha Rajonet. Rezultatet e plota të këtij Shqyrtimi dhe veprimet e propozuara për fuqizimin e kontrollit të cilësisë dhe trajnimin operativ të drejtuesve të ekipeve të projekteve do t'i raportohen Bordit në kohën kur do të diskutohet ky Raport i Grupit të Menaxherëve.

Duke pasur parasysh rëndësinë e gabimeve të identifikuara për Projektin, Presidenti i Bankës Botërore i ka kërkuar Juristit të Përgjithshëm në detyrë të kryejë një shqyrtim të rrethanave që lidhen me nxjerrjen e Ndreqjes së Gabimeve të muajit shtator 2008. Në bazë të këtij shqyrtimi, Presidenti i ka kërkuar Departamentit për Integritet Institucional të Bankës Botërore të drejtojë një Analizë të Llogaridhënies, për keqparaqitjen e pretenduar të informacionit përpara Panelit të Inspektimit dhe për ngjarjet që lidhen me përgatitjen e Projektit, paraqitjen përpara Bordit dhe mbikëqyrjen e Projektit.

Janë të papranueshme gabimet dhe mosrespektimi i standardeve të punës të Bankës, që kanë çuar në shkeljet e politikave të Bankës. Këto ngjarje dhe procese kanë

qenë të dhimbshme dhe të vështira për të gjithë. Duke parë nga e ardhmja, Grupi i Menaxherëve do të mbështetet në mësimet e nxjerra, për ta realizuar asistencën zhvillimore me standardet e larta, të cilat presin dhe meritojnë klientët dhe partnerët tanë.

I. HYRJE

1. Më 2 gusht 2007, Paneli i Inspektimit regjistroi një Kërkesë për Inspektim me numër RQ07/04 (e quajtur më tej në këtë Raport si “Kërkesa”), në lidhje me Projektin “Shqipëria: Projekti i Menaxhimit të Integruar dhe Pastrimit të Zonës Bregdetare” (Kredia nr 4083-ALB) financuar nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (SHNZH) (i quajtur më tej në këtë Raport si “Projekti”). Kërkesën për Inspektim e paraqitën përfaqësues të disa familjeve (të quajtur më tej në këtë Raport si “Kërkuesit”) të cilët bëjnë pjesë në një bashkësi që ndodhet në zonën e njohur me emrin Jalë, që është pjesë e fshatit Vuno të bashkisë Himarë në Shqipëri.

2. Çështja e ngritur përpara Panelit të Inspektimit ka të bëjë me prishjen e pesëmbëdhjetë ndërtesave në bashkësinë Jalë në datat 17-21 prill 2007, të realizuar nga Policia e Ndërtimit e Qeverisë së Shqipërisë (tani, Inspektorati i Ndërtimit). Kërkuesit pretendojnë se prishja e objekteve është kryer si pjesë e Projektit të financuar me fonde të Bankës Botërore. Për më tepër, Grupi i Menaxherëve është duke kërkuar informacione për prishjet e objekteve të tjera në zonën e Projektit, të cilat kanë ndodhur në të njëjtën kohë.¹

3. Më 2 gusht 2007 Drejtorët Ekzekutivë dhe Presidenti i Bankës Botërore janë njoftuar nga Paneli i Inspektimit për marrjen e Kërkesës. Më 17 shtator 2007, Grupi i Menaxherëve iu përgjigj pretendimeve të ngritura në Kërkesë. Në Raportin që i paraqiti Bordit, Paneli konstatoi se Kërkesa i plotësonte kushtet dhe u rekomandonte Drejtorëve Ekzekutivë të lejonin një investigim. Drejtorët Ekzekutivë e autorizuan investigimin më 1 nëntor 2007. Më 24 nëntor 2008, Paneli nxori raportin e tij, ku parashtroonte konstatimet e veta. Grupi i Menaxherëve i është mirënjohëse Panelit për paraqitjen e qartë dhe të plotë të konstatimeve. Në të vërtetë, Grupi i Menaxherëve është dakord me shumë prej konstatimeve dhe ndjen keqardhje të thellë për gabimet e bëra gjatë përgatitjes së Projektit, paraqitjes përpara Bordit dhe mbikëqyrjes së Projektit.²

4. Raporti që keni në dorë, i cili u përgjigjet konstatimeve të Panelit, është i organizuar në shtatë sekione. Në seksionin II jepet konteksti i situatës në bregdetin jugor të Shqipërisë. Në seksionin III përmbledhet statusi i Projektit. Në seksionin IV paraqiten çështjet kryesore që lidhen me Projektin. Këtu do të përfshihen: (a) Politika Operative e Bankës Botërore “Për shpërnguljen e detyruar”; (b) dështimet gjatë përgatitjes dhe mbikëqyrjes së Projektit; (c) një propozim për t’u ofruar asistencë Kërkuesve të varfër dhe/ose në pozita të cenueshme dhe për t’i asistuar personat e prekur nga prishja e objekteve e muajit prill 2007 përmes një procesi shqyrtimi gjyqësor të realizuar në kohë,

¹ Grupi i Menaxherëve ka marrë informacion për prishjen e përafërsisht 35 objekteve në bashkësitë e tjera në zonën e Projektit, të cilat kanë ndodhur në të njëjtën kohë. Veç kësaj, Grupi i Menaxherëve është në dijeni se objekte janë prishur gjatë gjithë vitit 2007 në Shqipërinë e Mesme dhe Shqipërinë e Veriut, jashtë zonës së Projektit.

² Në këtë Përgjigje të Grupit të Menaxherëve, termi “mbikëqyrje e Projektit” përdoret për veprimtaritë e realizuara nga punonjësit e Bankës Botërore, ndërsa “zbatim i Projektit” dhe “vënie në zbatim e Projektit” përdoren për veprimtaritë e realizuara nga Qeveria. Në të dy rastet, përdoren për periudhën kohore pas miratimit nga Bordi më 21 qershor 2005.

në mënyrë të pavarur dhe të monitoruar;³ (d) nëse merret vendimi për ta ristrukturuar Projektin, një propozim për të ecur përpara në lidhje me disa komponentë, ndërkohë që hiqet financimi për veprimtaritë e rregullimit të territorit; dhe (e) masat që duhen marrë për të siguruar cilësinë në të gjithë portofolin e huave të Bankës Botërore. Në seksionin V përshkruhen mësimet e nxjerra nga Banka Botërore. Në seksionin VI parashtrohet Plani i Veprimit i Grupit të Menaxherëve, që ndiqet nga përfundimet e paraqitura në seksionin VII.

II. KONTEKSTI I PROJEKTIT

5. **Rëndësia e Bregdetit të Jugut.** Me trashëgiminë e pasur kulturore, bukurinë natyrore dhe shumëllojshmërinë e florës dhe faunës, zona bregdetare e Shqipërisë është njëra prej pasurive më të vyera mjedisore dhe ekonomike në vend. **Bregdeti Jugor i Shqipërisë, që ndodhet në Detin Jon, është njëra prej zonave të pakëta të rajonin të Mesdheut, të cilat kanë mbetur të paprekura nga dora e njeriut.** Me zona të konsiderueshme të pazhvilluara, Shqipëria ka mundësinë e papërsëritur në Evropë për ta administruar zhvillimin në vijën e vet bregdetare, për të siguruar ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të pasurive natyrore, kulturore dhe ekonomike. Turizmi dhe aktivitetet e kohës së lirë përbëjnë një sektor të ekonomisë në Shqipëri, i cili ka kapacitetin për të krijuar vende pune dhe për të rritur të ardhurat. Gjatë vitit 2007, sektori i turizmit solli 14 për qind të produktit të brendshëm bruto dhe 11 për qind të vendeve të punës gjithsej.



³ Në të gjithë Përgjigjen, termi “prishja e objekteve e muajit prill 2007” përdoret për prishjen e ndërtimeve në Jalë dhe prishjen e objekteve të tjera në zonën e Projektit rreth kësaj kohe.

Foto 1: Zonë e paprekur nga dora e njeriut në Bregdetin Jugor të Shqipërisë

6. Zhvillimi i pakontrolluar përgjatë bregdetit verior të Shqipërisë ka ardhur për shkak të mungesës së institucioneve të efektshme për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm si edhe planet kombëtare dhe vendore të rregullimit të territorit dhe studimet e pjesshme urbanistike. **Bregdeti Jugor, me vijë bregdetare prej 168 km dhe popullsi rreth 70.000 banorë, është relativisht pak i zhvilluar, mirëpo gjendet nën tryzni nga ndërtimet e parregulluara, infrastruktura joadekuate, mosmbledhja e mbetjeve të ngurta dhe mostrajtimi i ujërave të zeza, ndërtimet e bëra në zonat e pambrojtura dhe përdorimi jo i qëndrueshëm i burimeve natyrore.**

7. **Rregullimi i territorit.** Planifikimi territorial është një qasje ndërdisiplinore dhe ndërsektoriale për rregullimin e territorit, për t'i arritur objektivat mjedisor, shoqëror dhe ekonomik në mënyrë të qëndrueshme. Ka të bëjë me përcaktimin e veprimtarive të lejuara në zonat, të cilat e veçojnë një lloj përdorimi të territorit nga një tjetër (për shembull, qendër banimi, tokë bujqësore) dhe përcakton rregullimin e zonave të përshtatshme për t'u ndërtuar (për shembull, dimensionet e ndërtesave, caktimin e trojeve të ndërtimit dhe madhësinë e lejuar të parcelës, kodet e ndërtimit). Një planifikim i suksesshëm, ndër të tjera, kërkon (a) që palët e interesuara të bien dakord për parimet bazë dhe (b) që institucionet të kenë kapacitetin për t'i orientuar proceset e planifikimit dhe për të përpiluar aktet normative. Kuadri i planifikimit duhet të jetë medoemos i drejtë, transparent dhe i mbështetur në kritere të justifikueshme (për shembull, të mos ndërtohet në zonat që janë të prekshme nga dukuria e përmytjeve, të mos ndërtohet në zonat pyjore). Për më tepër, është po aq një proces, sa ç'është edhe një produkt. Hartimi i planeve rajonale është një hap i nevojshëm por i pamjaftueshëm në procesin e planifikimit territorial. Është i nevojshëm rregullimi i territorit në nivel vendor, për të vendosur se si mund të administrohen sa më mirë burimet vendore.



Foto 2: Zhvillim i pakontrolluar në bregdetin mesdhetar të Shqipërisë

8. Menaxhimi integruar i zonës bregdetare (MIZB) aplikon rregullimin e territorit për zonat bregdetare, për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm. MIZB është një proces administrimi, i cili **ndihmon në vendosjen dhe zbatimin e një kuadri ligjor dhe institucional për të siguruar që planet e zhvillimit për zonat bregdetare të jenë të integruara me synimet mjedisore dhe sociale dhe të jenë hartuar me pjesëmarrjen e personave të prekur**. Synimi i MIZB-së është përmirësimi i përfitimeve faktike dhe të mundshme të zonave bregdetare (përfshirë edhe gamën e gjerë të shërbimeve të ekosistemeve që janë elemente të vetvetishme të sistemeve të shëndetshme) për shoqërinë, duke minimizuar, në të njëjtën kohë, efektet e dëmshme të veprimtarive njerëzore dhe rreziqet natyrore që u kanosen burimeve shoqërore, kulturore dhe mjedisore.

9. **Politika e Bankës Botërore “Për shpërnguljen e detyruar”**. Politika e Bankës Botërore “Për shpërnguljen e detyruar” (PO/PB 4.12) është një politikë kyçe për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo politikë ndodhet në qendër të njërës prej çështjeve më të debatueshme të zhvillimit: si duhen trajtuar personat pa tituj pronësie mbi tokën. Objektivi i PO/PB 4.12 është shmangia ose minimizimi i shpërnguljes së detyruar në kuadër të projekteve të financuar nga Banka Botërore dhe, kur kjo nuk është e realizueshme, asistimi i personave të shpërngulur për të përmirësuar ose, të paktën, për t'i rivendosur mjetet dhe standardet e tyre të jetesës. PO/PB 4.12 iu paraqit Bordit në vitin 2001, pas një serie të gjatë konsultimesh të jashtme dhe të brendshme, përfshirë edhe disa diskutime të CODE-së dhe Bordit. Në kohën kur është paraqitur, Grupi i Menaxherëve dhe Bordi vërenin se PO/PB 4.12 nuk kishte për qëllim të ishte një politikë e plotë sociale dhe se ajo nuk i mbulonte efektet e tërthorta.⁴

10. Është e deklaruar se mbulimi i PO/PB 4.12 është si vijon: “Kjo politikë mbulon efektet ekonomike dhe sociale të drejtpërdrejta, të cilat vijnë si rezultat i projekteve të investimeve të asistuar nga Banka dhe shkaktohen nga... (a) marrja me detyrim e tokës... dhe... (b) kufizimi me detyrim i hyrjes në parqet e përcaktuar me ligj dhe zonat e mbrojtura që sjell si rezultat efekte negative të padëshirueshme të mjetet e jetesës së personave të shpërngulur” (theksi është i shtuar).⁵

11. Edhe pse PO/PB 4.12 nuk është një politikë sociale e plotë, Grupi i Menaxherëve dhe Bordi kanë diskutuar për rëndësinë e një vlerësimi të mirë social, sidomos, për të mbrojtur grupet e varfra dhe të prekshme të popullsisë të cilët mund të vuajnë nga efektet

⁴ Për shembull, PO/PB 4.12 do të aplikohet në rastin e një projekti të infrastrukturës bregdetare që do të përfshinte një komponent për financimin e ndërtimit të një impianti të trajtimit të ujërave të zeza dhe, për pasojë, do të kërkonte marrjen e tokës për ndërtimin e impiantit. Në një rast të tillë, Banka Botërore do të kërkonte dhënien e kompensimit dhe të asistencës për shpërngulje për të gjithë ata të cilët e kanë përdorur tokën në fjalë, pavarësisht faktit nëse kanë apo jo titull mbi të. Megjithatë, PO/PB 4.12 nuk do të aplikohet në rastin e efekteve të tërthorta mbi bizneset dhe familjet fqinje, të cilat vuajnë humbjen e klientëve apo rënien e vlerës së tokës si shkak i ndërtimit të një impianti të trajtimit të ujërave të zeza aty pranë.

⁵ Paragrafi 3 i PO 4.12. Shih edhe paragrafin 4 të PO 4.12, ku vërehet se politika mund të aplikohet edhe në rastet e lidhura drejtpërdrejt, edhe sikur të mos jenë financuar nga Banka Botërore, nëse plotësojnë këto tri kushte: “Kjo politikë... aplikohet edhe për veprimtaritë e tjera që lindin si rezultat i shpërnguljes së detyruar, të cilat sipas gjykimit të Bankës (a) lidhen drejtpërdrejt dhe në mënyrë të konsiderueshme me projektin e asistuar nga Banka, (b) janë të nevojshme për të arritur objektivat e tij siç parashtrohen në dokumentet e projektit; dhe (c) realizohen ose planifikohen të realizohen në të njëjtën kohë me projektin.”

negative të padëshirueshme, paçka se jo të drejtpërdrejta, të projekteve të financuara nga Banka Botërore. Ky diskutim ka qenë shumë i rëndësishëm, sepse një numër qeverish kishin shqetësimin se nëse do të zbatohet me gjerësi të tepruar kjo politikë, atëherë kostot e paketave të shpërnguljes do të ishte tepër të larta. Për ta kuptuar nevojën për vlerësimet e mira sociale, politika thotë:

“Aty ku ka efekte negative të padëshirueshme sociale ose ekonomike të tërthorta, do të ishte praktikë e mirë që huamarrësi të ndërmerre një vlerësim social dhe të vinte në zbatim masa për minimizimin dhe zbutjen e efekteve ekonomike dhe sociale negative, sidomos për grupet e varfra dhe të prekshme të popullsisë. Përmes vlerësimeve mjedisore dhe raporteve e instrumenteve të tjera të projekteve mund të identifikohen dhe të trajtohen edhe efektet e tjera mjedisore, shoqërore dhe ekonomike, të cilat nuk vijnë si rezultat i marrjes së tokës.”⁶

12. PO/PB 4.12 parashtrojnë edhe veprimtaritë për të cilat nuk aplikohet. Këto përjashtime mbulohen nga poshtëshënimi 8, i cili rithekson rëndësinë e vlerësimit të mirë social. Në poshtëshënim thuhet:

“Kjo politikë nuk aplikohet për rregullimet e burimeve natyrore në nivel qendror ose rajonal për të nxitur qëndrueshmërinë e tyre, si për shembull administrimi i baseneve ujore, administrimi i ujërave nëntokësore, administrimi i peshkimit, etj. Kjo politikë nuk aplikohet as për mosmarrëveshjet midis palëve private në projektet e dhënies së titujve të tokës, edhe pse është e udhës që huamarrësi të ndërmarrë një vlerësim social dhe të zbatojë masa për minimizimin dhe zbutjen e efekteve sociale negative të padëshirueshme, sidomos të atyre efekteve që prekin grupet e varfra dhe të prekshme të popullsisë.”

13. Megjithatë poshtëshënimi 8 i PO/PB 4.12 nuk e përmend shprehimisht rregullimin e territorit, ai është një formë e rregullimit të burimeve natyrore që kishin për synim hartuesit të mbulohej nga politika në fjalë. Rregullimet e burimeve natyrore janë përjashtuar prej politikës në mënyrë që të sigurohet që qeveritë të mos jenë gjithmonë të detyruara të japin kompensim dhe asistencë për shpërnguljen personave të prekur nga veprimtari të tilla planifikimi dhe rregullimi, pavarësisht ligjshmërisë së përdorimit të tokës nga ana e tyre. Këto veprimtari ndryshojnë nga investimet konkrete në infrastrukturë, siç janë digat e mëdha, sepse nuk mund të piketohen konkretisht në një vendndodhje të caktuar dhe hartuesit e projektit nuk e dinë se ku, kur dhe si mund të preken njerëzit. Shembujt përkatës përfshijnë rastin kur ndihmohen qeveritë për t'u vënë fre ndërtimeve të përhapura në zonat që janë të prekshme nga përmblytjet apo kur ndihmohen për t'u dhënë fund ndërtimeve të paligjshme në zona delikate.

⁶ Poshtëshënimi 5 i paragrafit 3 të PO 4.12. Bordi dhe Grupi i Menaxherëve vërenin se këto masa të praktikës së mirë sociale duhej të merreshin në konsideratë në Librin Burimor për Shpërnguljen e Detyruar, që pritej të dilte atëherë (2004). Në faqen 20 të Librit Burimor përmenden “projektet për menaxhimin e burimeve kombëtare ose rajonale” dhe theksohet praktika e mirë e vlerësimeve sociale të shëndosha për të zgjidhur efektet sociale të padëshirueshme.

14. Nëse PO/PB 4.12 do të aplikohet për të gjithë personat e prekur brenda zonave të tilla që mbulon rregullimi, hartuesit e politikës e dinë se qeveritë nuk do t'ia lejonin vetes të ndërmerrnin këto nisma të rëndësishme. Paketat për shpërnguljen sipas PO/PB 4.12 do të kërkonin, ndër të tjera, që qeveria të paguante kompensimin e vlerës për shpërnguljen dhe të ofronte asistencë për mjetet e jetesës për të gjithë personat e prekur, pavarësisht faktit nëse ndërtesa është ndërtuar apo jo në mënyrë të ligjshme apo nëse zotërojnë apo jo titull të ligjshëm. Kështu, për shembull, një qeverie mund t'i kërkohej të paguante vlerën e ndërtimeve të ngritura në mënyrë të paligjshme në zona ku pasuritë e paluajtshme kanë vlerë të lartë pavarësisht të drejtave që kanë personat mbi këto prona. Aplikimi i politikës në veprimtaritë e rregullimit të territorit do të kërkonte që të plotësoheshin kushtet për kompensim për shkak të një zvogëlimi të mundshëm të vlerave të tokës në zona të caktuara si rezultat i ndryshimeve që sjell plani rregullues. Në raste të tilla, do të duhej të kompensohej përdorimi i ligjshëm i tokës në përputhje me ligjet vendore dhe procesin e rregullt që rregullojnë shpronësimin e pasurive.

15. Mbështetur në sa u tha më sipër, **Grupi i Menaxherëve e pranon se poshtëshënimi 8 i PO/PB 4.12 është i paqartë, sidomos në lidhje me rregullimin e territorit, dhe do ishte mirë të qartësohej. Termi “rregullim i territorit” nuk shfaqet në poshtëshënim dhe konfuzionin e ka krijuar kjo mospërmendje dhe mungesë niveli hollësie në dokumentin e politikës, që lidhet me aplikimin e poshtëshënit.** Grupi i Menaxherëve do të ndërmarrë një shqyrtim të aplikimit të politikave mbrojtëse në projektet që mbështesin planifikimin e përdorimit të tokës (rregullimit të territorit). Në bazë të këtij shqyrtimi, Grupi i Menaxherëve do të përgatisë dhe shpërndajë: (a) një qartësim të politikës në lidhje me mënyrën se si aplikohet poshtëshënimi 8 i PO/PB 4.12 në rastin e projekteve të rregullimit të territorit; dhe (b) një dokument udhëzues sa i takon aplikimit të politikave mbrojtëse në projektet që mbështesin rregullimin të territorit. Dokumenti Udhëzues do të theksojë se projektet e mira të rregullimit të territorit duhet të përfshijnë edhe shqyrtime të kuadrove ligjore dhe institucionale për të siguruar që palëve të prekura t'u ofrohet proces i rregullt dhe që të mbrohen grupet e varfra dhe të prekshme të popullsisë. Dokumenti Udhëzues do të mbulojë si aplikimin e PO/PB 4.12 ashtu edhe përdorimin e masave të tjera për të trajtuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Qartësimi i politikës dhe Dokumenti Udhëzues do të dalin më 30 qershor 2009. Grupi i Menaxherëve do të ndërmarrë veprimtari afrimi me publikun dhe trajnuese për personelin për t'i shpërndarë këto masa në mënyrë të efektshme.

16. **Çështjet komplekse të lidhura me rregullimin e territorit në Shqipëri.** Sfidat historike e kanë kompromentuar zhvillimin e një sistemi të efektshëm dhe të plotë për rregullimin e territorit në Shqipëri. Shqipëria ka pasur suksese shumë të vogla sa i takon rimarrjes së vetes nga rishpërndarja dhe kolektivizimi i tokës bujqësore, të filluar në vitin 1945, dhe nga ndalimi i mëpasshëm i pronës private dhe kolektive në vitin 1976. **Pas rënies së regjimit komunist në vitin 1991, Shqipëria ka miratuar shumë ligje në lidhje me reformën e pronave dhe tokës (disa prej të cilëve bien ndesh me njëri tjetrin), nisi një fushatë privatizimi masiv dhe nxori me qindra mijëra dokumente që krijojnë të drejta të ligjshme mbi pronat (disa prej të cilave janë nxjerrë për të njëjtën pronë).** Si rezultat i akteve ligjore të shumta, akteve nënligjore relativisht të pakëta dhe institucioneve të dobëta, veprimtaritë në sektorin e ndërtimeve janë tepër joformale. Veç kësaj, zhvillimi dhe planifikimi urban është bërë pa ndonjë planifikim

paraprak dhe jo mbi bazë të kriterëve dhe standardeve transparente. Duke pasur parasysh këto sfida, pas mesit të viteve '90, Qeveria i është kthyer një programi në mbarë vendin, për të prishjeve të detyruara, si një instrument për të mbajtur në kontroll ndërtimet e parregulluara.

17. Rregullimi i kufizuar apo joadekuat i territorit ka pasur pasoja të rënda: zhvillim i pakontrolluar; mbrojtje e pamjaftueshme e burimeve ekonomike dhe mjedisore; një numër shumë i madh i ndërtimeve pa leje ndërtimi; dhe mungesë e infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve. Një raport i vitit 2006 i Bankës Botërore, që citohet në Raportin e Investigimit të Panelit të Inspektimit, vëren se janë bërë nënndarje të paligjshme të tokës dhe projekte ndërtimi, kryesisht në periferitë e qyteteve dhe zonat turistike. Këto zona janë të përfshira edhe në tregun “joformal” të shtëpive dhe përbëjnë një inventar pasurish pa mbrojtje juridike.⁷

18. Në shumë vende të Mesdheut, kanë ngritur ndërtesa pa leje apo tituj pronësie mbi tokën. Siç ndodh edhe në Shqipëri, shumë prej këtyre ndërtimeve janë ngritur në mënyrë të paligjshme sepse nuk ka pasur plane rregulluese dhe se njerëzit nuk i merrnin dot lejet e nevojshme. Në këtë kuadër, praktika më e mirë përfshin (a) futjen në rregulla të ndërtimeve të paligjshme aty ku është e mundur, në bazë të planeve lokale rregulluese, (b) heqjen dorë nga prishja e objekteve pas faktit, për të filluar parandalimin qysh në burim të zhvillimit të paqëndrueshëm dhe të parregulluar, dhe (c) realizimi i një vlerësimi social, sidomos për të identifikuar dhe zbutur efektet sociale të padëshirueshme.

19. Duke pasur parasysh nevojën e ngutshme për t'i trajtuar këto probleme dhe humbjen e vazhduar të pasurive të vyera mjedisore të bregdetit jugor të Shqipërisë, Qeveria e Shqipërisë i kërkoi Bankës Botërore mbështetje për Projektin në fillim të vitit 2004. Pak kohë pas kësaj, Qeveria kërkoi edhe një projekt për administrimin e tokës, për të përmirësuar sigurinë e të drejtave mbi pronat dhe për të ngritur tregje toke funksionuese. Më 22 shkurt 2007, Bordi i Drejtorëve Ekzekutiv aprovoi Projektin e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës në Shqipëri, për të trajtuar këto çështje.

III. STATUSI I PROJEKTIT

20. ***Përshkrimi i Projektit.*** Projektin është përgatitur në vitin 2004 dhe 2005 dhe është miratuar nga Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë më 21 qershor 2005. Projektin synon të asistojë Qeverinë e Shqipërisë “**për të vendosur një qasje të integruar për menaxhimin e zonës bregdetare përmes realizimit të reformës së politikave, zhvillimit institucional dhe investimeve për mbrojtjen e burimeve bregdetare për të nxitur zhvillimin dhe administrimin e qëndrueshëm të bregdetit jugor të Huamarrësit.**” Projektin mbulon një zonë gjeografike nga Qafa e Llogorasë deri në kufirin me Greqinë (shih Hartën). Krahas përgatitjes së Planit të Zhvillimit të Bregdetit Jugor (PZHBJ) dhe planeve vendore të rregullimit të territorit, Projektin financon ndërtimin e një vend-groposje për mbeturina dhe zhvillimin e një sistemi për administrimin e mbetjeve të ngurta, ndërtimin e një terminali pasagjerësh në Portin e

⁷ Banka Botërore, Tiranë, “Statusi i reformës së tokës dhe tregjet e pronave të paluajtshme në Shqipëri”, 2006, faqe 7.

Sarandës, investime të rrjete të vogla të ujësjellës-kanalizime në bashkinë Sarandë dhe fshatrat e vegjël në Bregdetin Jugor, investime me bazë komunitetin në fshatrat bregdetare dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore në Parkun Kombëtar të Butrintit. Projekti përfshin edhe një komponent për të pastruar mbetjet e ngurta të rrezikshme në Porto-Romano, pranë Durrësit. PO 4.12 aplikohet për veprimtaritë e mbështetura në kuadër të komponentëve për ofrimin e infrastrukturës në shkallë të vogël dhe pastrimin e një pike të nxehtë mjedisore.

21. Projekti është faza e parë e një Programi të Menaxhimit të Integruar dhe Pastrimit të Zonës Bregdetare, të parashikuar me dy faza. Kostoja gjithsej e kësaj faze të parë çmohet se është rreth 38,56 milion USD, nga të cilat 17,5 milion USD financohen me një kredi të Bankës Botërore. Në bashkëfinancim përfshihen 5,71 milion USD nga Qeveria e Shqipërisë, 5,20 milion USD nga Komisioni Evropian, 3,11 milion USD nga Qeveria e Holandës, 2,6 milion USD nga Qeveria e Austrisë, 2,23 milion USD nga Qeveria e Japonisë, 0,95 milion USD nga Fondi Global për Mjedisin dhe 1,26 milion USD nga përfituesit.

22. Deri tani, veç përgatitjes dhe aprovimit të PZHBJ-së, Projekti ka pasur arritjet si vijon: (a) punë e hollësishme për projektimin dhe Vlerësimi i Efektit Mjedisor për shndërrimin e Portit të Sarandës në një terminal përkushtuar trageteve dhe udhëtarëve; (b) dymbëdhjetë projekte infrastrukture me bazë komunitetin në ndërtim e sipër, përfshirë pesë ujësjellës dhe shtatë rrugë rurale; (c) investigim në vend dhe punë e hollësishme projektimi, pranë përfundimit, për vend-groposjen e mbetjeve të ngurta pranë Sarandës dhe stacionin e kalimit në Himarë; (d) rivendosje e kënaqshme e pesë familjeve, në lidhje me pastrimin e Porto-Romanos, dhe punë e hollësishme projektimi për izolimin e kontaminimit në ish-uzinën kimike; (e) projekti teknik i hollësishëm për investimet në ujësjellës-kanalizime në Sarandë; dhe (f) përgatitja e Planit të Administrimit për Parkun Kombëtar të Butrintit.

23. **Komponenti “Plani i Zhvillimit të Bregdetit të Jugut”.** PZHBJ është aprovuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Rrethit të Vlorës më 1 korrik 2008 dhe nga Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit më 17 korrik 2008. PZHBJ është një plan rajonal, që duhet plotësuar me planet vendore rregulluese, të hartuar me pjesëmarrje (shih Aneksin 1). Ky plan ka për synim nxitjen e administrimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke minimizuar, në të njëjtën kohë, efektet negative mjedisore të zhvillimit dhe infrastrukturës vendore, në bazë të integritetit të planifikimit mjedisor dhe zhvillimit të qëndrueshëm në procesin e marrjes së vendimeve. PZHBJ është një instrument për nxitjen e turizmit të qëndrueshëm, si një katalizator parësor i rritjes ekonomike, në ekonominë rajonale.

24. PZHBJ përfshin një sërë rregulloresh për bregdetin, të cilat ofrojnë: (a) një kuadër të qartë për njësitë e pushtetit vendor, për të mundësuar përgatitjen e planeve rregulluese vendore të qarta dhe konsekuente; (b) orientim për hartimin e hollësishëm të rregulloreve vendore, brenda kuadrit të rregulloreve rajonale; dhe (c) një nivel të parë të rregulloreve për planet vendore të rregullimit të territorit. Një rregullore kyçe vëren si më poshtë:

Vija e ndërtimit për strukturat e përhershme në vijat e forta (shkëmbore) bregdetare spostohet në një distancë të paktën njëqind (100) metra nga vija e rrymës ujore të kulmit të baticës. Vija e ndërtimit për strukturat e përhershme në vijën e butë bregdetare (grumbullime rëre dhe zhavorri) spostohet, gjithashtu, njëqind (100) metra, por kjo është subjekt i modifikimit për projektet e mëdha të zhvillimit bregdetar, të cilat kërkojnë Vlerësim të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe në rastet kur një studim mund të rekomandojë një shifër më të madhe.⁸

PZHBJ mbështetet në Kodin Etik për Zonat Bregdetare të Bashkimit Evropian (BE). Kodi i BE-së përqafton parimet strategjike të “Strategjisë për shumëllojshmërinë biologjike dhe tokësore pan-evropiane”, që përkufizon elementet kyçe në lidhje me zhvillimin dhe administrimin e zonave bregdetare. Me aprovimin e PZHBJ-së, tani mund të ecë përpara puna për planet rregulluese vendore.

25. ***Prishja e objekteve në prill 2007 dhe Kërkesa për Inspektim.*** Në muajin prill 2007, Qeveria ka bërë prishje objektivësh përgjatë bregdetit shqiptar, përfshirë edhe objekte në zonën e Projektit. Gjatë periudhës 17-21 prill 2007, janë prishur tërësisht ose pjesërisht pesëmbëdhjetë ndërtesa në bashkësinë Jalë. Në kohën kur ka ndodhur prishja e objekteve, Kërkuesit u ankuan pranë Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë, Shqipëri. Banka Botërore dërgoi në terren një “Mision Fakt-mbledhës”, në muajin maj 2007, por nuk bëri një takim me Kërkuesit dhe as iu përgjigj ankesave të tyre, në atë kohë. Më 25 korrik 2007, Kërkuesit depozituan një kërkesë për inspektim.

26. ***Takimet me Kërkuesit në lidhje me prishjen e objekteve në Jalë.*** Gjatë rrjedhës së investigimit të Panelit të Inspektimit, Grupi i Menaxherëve është takuar me Kërkuesit në dy raste dhe me një përfaqësues në Tiranë, Shqipëri, në disa raste. Në muajin maj 2008, Grupi i Menaxherëve është takuar me Kërkuesit në Jalë. Në muajin nëntor 2008, punonjës të nivelit të lartë janë takuar me Kërkuesit në Jalë, takim, i cili është ndjekur nga një tjetër, ditën e nesërme, në, të cilin morën pjesë edhe Drejtori Rajonal për Operacionet dhe Strategjinë dhe një përfaqësues i Qeverisë së Shqipërisë.⁹ Së fundmi, në muajin dhjetor 2008, punonjës të nivelit të lartë janë takuar me një përfaqësues të Kërkuesve, për të diskutuar për statusin e çështjes në ndjekje nga Paneli i Inspektimit. Janë planifikuar konsultime të tjera me Kërkuesit, për muajin janar 2009, për të diskutuar asistencën për Kërkuesit, në kuadër të Planit të Veprimit të Grupit të Menaxherëve.

27. ***Trajtimi i nevojës për përmirësimin e kuadrit organizativ për vënien në zbatim të Projektit.*** Sikurse trajtohet edhe në seksionin IV, më poshtë, janë identifikuar mangësi të rënda në përgatitjen, zbatimin dhe mbikëqyrjen e Projektit dhe, sidomos, në komponentin e PZHBJ-së. Gjatë përgatitjes së këtij Raporti të Grupit të Menaxherëve, ka dalë qartë se kuadri organizativ i tanishëm për vënien në zbatim të tij nuk mund t’i arrijë objektivat e Projektit, në një mënyrë që të jetë e pranueshme për Bankën Botërore. Në kushtet e mangësive të identifikuara në kuadrin organizativ të zbatimit dhe në mungesë të

⁸ Rregulloret që ishin në fuqi përpara miratimit të PZHBJ-së vendosnin vija kufizuese më të shtrënguara.

⁹ Të paktën, një prej Kërkuesve jeton jashtë shtetit dhe nuk ka marrë pjesë në takimet e muajve mars dhe nëntor 2008.

modifikimit të tij, që do të siguronte që projekti të mund të realizohej në përputhje me objektivat zhvillimor të deklaruar, Banka Botërore ka lëshuar një letër pezullimi më 9 janar 2009.

28. ***Pezullimi i Kredisë.*** Gjatë gjashtë muajve të fundit, Grupi i Menaxherëve ka diskutuar me Qeverinë për kuadrin e veprimeve për ta përmirësuar zbatimin e Projektit, përfshirë edhe një pezullim të përkohshëm të prishjes së ndërtimeve ekzistuese në zonën e Projektit deri në përmbushjen e kushteve konkrete. Mirëpo, Qeveria e Shqipërisë e ka informuar Grupin e Menaxherëve se nuk është e gatshme, tani për tani, të bëjë shtesa dhe ndryshime në Marrëveshjen e Kredisë, për të pasqyruar pezullimin e prishjes së ndërtimeve ekzistuese në zonën e Projektit, hap, të cilin Grupi i Menaxherëve e konsideron thelbësor për të siguruar që Projekti të ketë një bazë ligjore të shëndoshë për zbatimin me sukses të tij. Në mungesë të një ndryshimi të tillë, që do të ishte i nevojshëm për t'u kujdesur që Projekti të mund të realizohet në përputhje me objektivat zhvillimore të deklaruara, më 9 janar 2009 Projekti është pezulluar.

IV. ÇËSHTJET KRYESORE

29. Në këtë seksion jepet informacion për çështjet e mëposhtme kyçe të Raportit të Investigimit të Panelit: (a) Politika Operative e Bankës Botërore “Për shpërnguljen e detyruar”; (b) dështimet gjatë përgatitjes dhe mbikëqyrjes së Projektit; (c) një propozim për t'u ofruar asistencë Kërkuesve të varfër dhe/ose në pozita të cenueshme dhe për t'i asistuar personat e prekur nga prishja e objekteve në muajin prill 2007 përmes një procesi shqyrtimi gjyqësor të realizuar në kohë, në mënyrë të pavarur dhe të monitoruar; (d) nëse merret vendimi për ta ristrukturuar Projektin, një propozim për të ecur përpara në lidhje me disa komponentë, ndërkohë që hiqet financimi për veprimtaritë e rregullimit të territorit; dhe (e) masat e marra për të siguruar cilësinë në të gjithë portofolin e huave të Bankës Botërore.

A. PO/PB 4.12 “SHPËRNGULJA E DETYRUAR”

30. ***Aplikimi i Politikës.*** Në kohën kur i është paraqitur Projekti Bordit, Grupi i Menaxherëve gjykonte se PO/PB 4.12 nuk aplikohet për përgatitjen e PZHBJ-së dhe vlerësonte se programi, në zbatim e sipër, i Qeverisë për prishjen e objekteve ishte jashtë objektit të Projektit. Grupi i Menaxherëve ishte e mendimit se PZHBJ ishte një veprimtari që administronte burimet natyrore, e përjashtuar nga politika, për shkak të poshtëshënimit 8 të lidhur me paragrafin 3 të PO/PB 4.12, që i përjashton “rregullimet e burimeve natyrore në nivel kombëtar apo rajonal që nxisin qëndrueshmërinë e tyre”. **Grupi i Menaxherëve e pranon se poshtëshënimi 8 i PO/PB 4.12 është i paqartë dhe kërkon të qartësohet, nëse i përfshin apo jo edhe veprimtaritë e rregullimit të territorit.**

31. Pavarësisht faktit nëse duhej të ishte aplikuar apo jo PO/PB 4.12, **ky nuk është një justifikim për mosaplikimin e praktikës së mirë për ato lloje të efekteve negative të padëshirueshme sociale dhe ekonomike të cilave duhet t'u kishte paraprirë Grupi i Menaxherëve.** Kjo do të kishte ndihmuar në shmangien e efekteve negative të padëshirueshme për Kërkuesit dhe për reputacionin e Bankës Botërore. Skema e Projektit nuk përfshiu një vlerësim të plotë të aspekteve shoqërore, juridike dhe institucionale apo

mekanizma e procesit të rregullt të cilët do të kishin ndihmuar në mbrojtjen e Kërkuesve. Në dritën e kërcënimit të ditur të prishjes së mundshme të objekteve, Grupi i Menaxherëve duhet të kishte ngulur këmbë për vendosjen e një moratoriumi mbi veprimtaritë e prishjes së objekteve në zonën e Projektit deri në çastin kur do të ishin përgatitur PZHBJ dhe planet vendore përkatëse dhe kur do të vihej në zbatim paketa e masave të mbrojtjes sociale.

32. Paneli i Inspektimit arriti në përfundimin se PO/PB 4.12 duhej të ishte aplikuar për përgatitjen e PZHBJ-së dhe për programin në zbatim e sipër të Qeverisë për prishjen e objekteve. **Grupi i Menaxherëve i pranon konstatimet e Panelit në lidhje me veprimet e Njesisë Shqiptare të Koordinimit të Projektit dhe efektet që kanë pasur ato për Kërkuesit.** Grupi i Menaxherëve vëren se prishja e objekteve në Jalë nuk ka qenë autorizuar nga Banka Botërore. Megjithatë, Grupi i Menaxherëve është në dijeni se më datë 26 mars 2007, më pak se një muaj përpara prishjes së objekteve në bregdetin jugor, Njësia Shqiptare e Koordinimit të Projektit u ka dërguar një letër, me kokën zyrtare të letërkëmbimit të Projektit, qeveritarëve të nivelit të lartë, si edhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Ndërtimit. Në këtë letër, Njësia e Koordinimit të Projektit vëren se po vazhdojnë ndërtimet e paligjshme në bregdetin jugor të Shqipërisë dhe thotë se,

“Duke pasur parasysh rëndësisë e zhvillimit të qëndrueshëm të kësaj zone dhe efektin që ka në zhvillim e përgjithshëm ekonomik dhe të turizmit në vend, sa i takon mjedisit, ju lutem kujdesuni të merrni masat e nevojshme, sa më shpejt të jetë e mundur.” [Nënvizimi është i shtuar.]

Pas më pak se dy javësh, Policia e Ndërtimit i është përgjigjur Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Njesisë së Koordinimit të Projektit, ku u bënte me dije se,

“Drejtoria e Policisë së Ndërtimit ka kryer të gjitha procedurat ligjore të nevojshme që kanë të bëjnë me raste të tilla dhe vendimet për prishjen e këtyre objekteve u janë njoftuar palëve përkatëse, duke u dhënë atyre mundësinë e bërjes së ankesës dhe të paraqitjes së dokumenteve që kanë për këto ndërtime.” [Nënvizimi është i shtuar.]

Prishja e objekteve në Jalë filloi pas një jave. **Grupi i Menaxherëve e pranon se prishja e këtyre objekteve i ka prekur negativisht Kërkuesit. Grupi i Menaxherëve pranon gjithashtu se veprimet që kanë ndodhur ilustronë paqartësinë e faktit nëse duhej aplikuar apo jo PO/PB 4.12, duke pasur parasysh veprimtaritë në zbatim e sipër të Qeverisë për prishjen e objekteve në zonën e Projektit. Grupi i Menaxherëve është dakord se ngjarjet në terren kanë krijuar një situatë, në të cilën palëve të prekura u duhet dhënë asistencë (shih paragrafin 53).**

33. **Grupi i Menaxherëve pajtohet me Panelin e Inspektimit se mbikëqyrja e Projektit nuk ka funksionuar si duhet.** Pasi mësoi për prishjen e objekteve, Grupi i Menaxherëve duhet të kishte vepruar menjëherë, për t'u takuar me personat e prekur dhe për të diskutuar me Qeverinë për mjetet e zbutjes së efekteve negative. Për më tepër, qysh prej fillimit të vënies në zbatim të Projektit, Grupi i Menaxherëve duhet ta kishte sqaruar

rolin e Njesisë së Koordinimit të Projektit në raport me programin në zbatim e sipër të Qeverisë për prishjen e objekteve, duke ditur rreziqet që u kanoseshin objektivave të Projektit për shkak të programit të prishjes së objekteve.

B. MOSRESPEKTIMI I POLITIKËS PËR PËRGATITJEN E PROJEKTEVE (PO/PB 10.00) DHE POLITIKËS PËR MBIKËQYRJEN E PROJEKTEVE (PO/PB 13/05)

34. *Janë bërë një sërë gabimesh gjatë gjithë ciklit të Projektit, përfshirë fazat e përgatitjes së Projektit, paraqitjes përpara Bordit dhe mbikëqyrjes së Projektit, si edhe gjatë përgatitjes së Përgjigjes së parë të Grupit të Menaxherëve, në shtator 2007, dhe gjatë nxjerrjes së Ndreqjes së Gabimeve në Dokumentin e Vlerësimit të Projektit, në shtator 2008. Këto gabime janë të papranueshme dhe nxjerrin në pah një mosfunksionim të rëndë të mekanizmave të llogaridhënies, përgjegjësisë dhe kontrollit mbikëqyrës që ushtron mbi Projektin Grupi i Menaxherëve. Grupi i Menaxherëve i është mirënjohës Panelit të Inspektimit, për faktin që ia ka sjellë në vëmendje këto gabime, dhe pajtohet me Panelin se janë shkelur PO/PB 10.00 “Për huadhënien për investime—nga identifikimi deri në paraqitjen përpara Bordit” dhe PO/PB 13.05 “Për mbikëqyrjen e projekteve”. Më poshtë, jepet një përmbledhje e gabimeve të bëra në rrjedhën e përgatitjes dhe mbikëqyrjes së Projektit.*

Përgatitja e Projektit (PO/PB 10.00 “Për huadhënien për investime—nga identifikimi deri në paraqitjen para Bordit”)

35. *Sikurse përshkruhet në paragrafin 22, Projekti ka një numër komponentësh që janë jashtëzakonisht të gjerë, të ndryshëm nga njëri-tjetri dhe të përhapur nga ana gjeografike. Në fund të përgatitjes së Projektit, është shtuar komponenti i ujësjellës-kanalizimeve në Sarandë. Hartimi i përshtatshëm i një projekti që ka këtë nivel kompleksiteti do të donte një ekip projekti me shumë përvojë dhe me njohuritë teknike përkatëse, si edhe një kontroll mbikëqyrës të ushtruar nga afër nga Grupi i Menaxherëve. Grupi i Menaxherëve të Lartë nuk caktoi një ekip projekti me aftësitë dhe përvojën teknike të nevojshme. Për më tepër, kontrolli mbikëqyrës nga drejtuesit e sektorit dhe të vendit ka qenë jo e njëtrajtshme dhe me fokus të dobët.*

36. *Logjika mbi të cilën mbështetet moszbatimi i PO/PB 4.12 nuk është dokumentuar mjaftueshëm në DVP. Sikurse vërehet më lart, gjatë përgatitjes së Projektit, ekipi i ngarkuar me projektin, në bashkëpunim me autorët parësor të PO/PB 4.12, arritën në përfundimin se politika e Bankës Botërore “Për shpërnguljen e detyruar” nuk aplikohet në rastin e veprimtarive të rregullimit të territorit në kuadër të Projektit, në bazë të poshtëshënimit 8 të Politikës, dhe se kjo politikë nuk aplikohet në rastin e programit në zbatim e sipër të Qeverisë për prishjen e detyrueshme të objekteve. Për këto vendime janë zhvilluar diskutime të gjalla. Mirëpo, logjika mbështetëse nuk është parashtruar mirë në DVP. Për shembull, në të nuk përmendet fare poshtëshënimi 8.*

37. *Rreziqet që shoqërojnë programin në zbatim e sipër të Qeverisë për prishjen me detyrim të objekteve, si për popullatën e zonës së Projektit ashtu edhe për reputacionin e Bankës Botërore, nuk janë vlerësuar sa duhet dhe as nuk janë zbutur si duhet. Në dallim nga praktika e mirë, gjatë përgatitjes së Projektit nuk janë kryer vlerësime*

sociale, institucionale apo ligjore të plota. Më 28 shkurt 2005, ekipin e projektit e ka këshilluar LEG të ndjekë disa masa zbutjeje, të cilat, të marra së bashku, do të kishin qenë të përshtatshme për të mbrojtur si popullatën e zonës së Projektit ashtu edhe reputacionin e Bankës Botërore. Në këto masa përfshiheshin: (a) një moratorium mbi programin në zbatim e sipër të Qeverisë për prishjen me detyrim të objekteve në zonën e Projektit; (b) asistencë për popullatën e varfër dhe në pozita të cenueshme, të prekur nga prishja e objekteve, e cila mund të ndodhte pas përfundimit të PZHBJ-së dhe planeve vendore rregulluese; dhe (c) përmirësime në procedurat e Qeverisë, në lidhje me prishjen me detyrim të objekteve. Mirëpo, Qeveria nuk ra dakord për moratoriumin dhe dy masat e fundit nuk u financuan në kuadër të Projektit.

38. **Projekti nuk duhej t'i ishte paraqitur për miratim Bordit, në mungesë të një moratoriumi për prishjen e ndërtimeve ekzistuese, dhe as kjo masë nuk është ndjekur në mënyrë aktive me Qeverinë.** Gjatë Misionit Paravlerësues, të realizuar më 21 shkurt - 8 mars 2005, Ekipi i Projektit kërkoi të arrinte një marrëveshje me Qeverinë e Shqipërisë, për një moratorium mbi prishjen e objekteve. Qeveria ishte kundër një moratoriumi të tillë, duke qenë se mendonte se kjo masë do të binte ndesh me legjislacionin shqiptar. Gjithashtu, ajo do t'i shtynte njerëzit të bënin edhe më shumë ndërtime të paligjshme. Mirëpo, Ekipi i Projektit nuk ia sqaroi Qeverisë se një moratorium mbi prishjen e objekteve do të mbronte vetëm ndërtimet ekzistuese, dhe jo ndërtimet e reja të paligjshme. Për më tepër, dialogu për moratoriumin e propozuar është zhvilluar vetëm në nivel të zëvendësministrit përgjegjës për Projektin. Drejtori për Vendin vazhdimisht kishte theksuar në diskutimet me kryeministrat e ndryshëm të vendit, se nuk është mirë të bëhet prishja e objekteve pa një vlerësim të korrektë sociale të masës në fjalë, dhe mendonte se kjo pikëpamje ishte mirëpritur në nivelet më të larta. Megjithatë, këto diskutime ishin të një natyre të përgjithshme dhe, as janë dokumentuar, e as janë lidhur konkretisht me përgatitjen e Projektit. Ekipi i Projektit nuk e mobilizoi ndihmën e Drejtorit për Vendin apo të Shefit të Zyrës në Tiranë, për të siguruar një moratorium për Projektin. Ka pasur shumë pak komunikimin midis Ekipit të Projektit dhe Sektorit të Administrimit për Vendin, dhe i njëjti komunikim i dobët ka qenë edhe brenda vetë Ekipit të Projektit. Kjo ka çuar në situatën kur nuk dihej mirë, në kishte apo jo një moratorium. Për më tepër, Ekipi i Projektit nuk nxori një Promemorje për Misionin Paravlerësues. Kështu që nuk ka asnjë dokumentim të diskutimeve me Qeverinë për moratoriumin.

39. **Vlerësimi dhe Negociatat janë mbyllur pa një mirëkuptim të përbashkët apo një marrëveshje brendapërbrenda Ekipit të Projektit dhe midis Ekipit të Projektit dhe Njësisë së Administrimit për Vendin, në lidhje me rreziqet e Projektit dhe mjetet për t'i trajtuar ato.** Pas Misionit Paravlerësues, është zhvilluar më 29 mars 2005 një takim, në të cilin kanë marrë pjesë drejtues dhe punonjësit përkatës të Bankës Botërore, për të diskutuar masat për zbutjen e rreziqeve në lidhje me prishjen me detyrim të ndërtimeve. Duke qenë se nuk ka një procesverbal të kësaj mbledhjeje të rëndësishme, nuk është e qartë nëse është diskutuar apo jo shprehimisht për mospranimin nga ana e Qeverisë për të rënë dakord për një moratorium. Shefi i Sektorit përgjegjës për Projektin e miratoi paketën e Mbledhjes për Vendimin, pa asnjë paraqitje të qartë të rreziqeve dhe masave të duhura për zbutjen e tyre. Më 7 prill 2005, Mbledhja për Vendimin konfirmoi se në rastin e veprimtarive të rregullimit të territorit dhe ndryshimit të destinacionit të tokës, nuk

aplikohej PO/PB 4.12, por e udhëzoi Ekipin e Projektit të kërkonte orientime të mëtejshme nga sektorët e duhur, për të siguruar një vlerësim të korrektësisë në lidhje me aspektet sociale dhe parashikimet për procedurën e ankimit. Megjithatë, Misioni i Vlerësimit, i zhvilluar më 12-16 prill 2005, nuk kishte asnjë specialist social apo jurist. Fleta e të Dhënave të Masave Mbrojtëse (ISDS) e nxjerrë më 13 prill 2005 e keqparaqiste PO/PB 4.12, miratonte një Kuadër të Masave Mbrojtëse Mjedisore dhe Sociale (ESSF) në të cilin kishte shumë gabime dhe nuk i trajtonte si duhet rreziqet dhe masat zbutëse për to. E, megjithatë, ISDS u nënshkrua nga Shefi i Sektorit përgjegjës për Projektin dhe nga Koordinatori Rajonal për Masat Mbrojtëse. Drejtori për Vendin dha lejen për Vlerësimin dhe Negociatat përpara se të mbylleshin diskutimet për çështjen e masave zbutëse për rreziqet.

40. *Grupi i Menaxherëve pajtohet me Panelin e Inspektimit se DVP-ja e keqparaqiste ekzistencën e një marrëveshjeje me Qeverinë për një moratorium mbi prishjen me detyrim të objekteve.*¹⁰ *Keqparaqitja në fjalë kishte të bënte me një aspekt jetik në skemën e Projektit.* Më 14 prill 2005, Shefi i Sektorit për Zhvillim Social, në konsultim me LEG, i dërgoi Ekipit të Projektit një propozim për gjuhën që duhet të përfshinte në rubrikën e DVP-së, e cila mbulonte zbutjen e rreziqeve. Në gjuhën e propozuar përfshihej edhe përmendja e një moratoriumi. Ekipi i Projektit, edhe pse e dinte mirë se kundërpalët e tij në Qeveri nuk kishin rënë dakord për një moratorium, e futi këtë gjuhë në DVP, pa e lexuar me kujdes atë, duke përfshirë, kështu, një gabim në DVP. **DVP-ja e kaloi fazën e miratimit për Negociatat dhe, më pas, iu paraqit Bordit, dhe asnjëra prej palëve aprovuese nuk e vunë re gjuhën e gabuar në lidhje me moratoriumin.** Juristi për Vendin dhe Kryekëshilltari Rajonal e aprovuan paketën e Bordit, vetëm në bazë të një shqyrtimi të dokumenteve juridike, që nuk e përmendnin moratoriumin. Shefi i Sektorit për Mjedisin dhe Burimet Natyrore, përgjegjës për Projektin, që ishte në dijeni të faktit se Qeveria nuk kishte rënë dakord për një moratorium dhe që e ishte aprovuar DVP-në në fazën e Vendimit përpara se të përfshihej gabimi në të, e aprovoi DVP-në për t'u paraqitur përpara Bordit, pa e vënë re gabimin kritik në të. Shefi i Zyrës në Vend dhe Drejtori për Vendin e aprovuan DVP-në, pa e vënë re mospërputhjen midis dokumenteve juridike. **Duket qartë se shumë hallka kontrolli dështuan në misionin e tyre dhe se ka pasur një defekt në procesin e shqyrtimit menaxherial.**

41. *Për ta përmbledhur, stafi drejtues që mbulonte vendin dhe sektorin nuk i ushtruan përgjegjësitë e tyre me konsekuencë, nuk caktuan një ekip projekti me njohuritë e duhura prej ekspertit dhe me përvojën e duhur dhe nuk ushtruan kontrollin mbikëqyrës të përshtatshëm për ekipin e projektit.* Stafi drejtues i sektorit nuk u kujdes që misionet të kishin stafin e duhur. Stafi drejtues për vendin dha lejen për vlerësimin dhe negociatat në një kohë kur nuk ishin trajtuar ende tërësisht rreziqet kryesore dhe masat zbutëse për to. Stafi drejtues për vendin dhe për sektorin i kanë aprovuar dokumentet kyçe pa i parë me kujdes. Ekipi i ngarkuar me projektin nuk komunikoi rregullisht me stafin drejtues për vendin dhe për sektorin në lidhje me statusin e përgatitjes së Projektit,

¹⁰ Në faqen 15 të DVP-së thuhet, "Qeveria ka rënë dakord se largimi i mëtejshëm i zaptimeve do të bëhet vetëm pasi të jenë vendosur kriteret dhe procedurat për identifikimin dhe asistimin e personave të prekur vulnerabël."

as nuk i ngriti problemet apo mosmarrëveshjet kur kanë lindur. Ekipi i projektit nuk nxori Promemorje për misionin paravlerësues dhe vlerësues dhe nuk i qarkulloi procesverbalet e mbledhjeve të rëndësishme. **Gjatë gjithë përgatitjes së Projektit, komunikimi mes vetë anëtarëve të ekipit të projektit dhe midis ekipit të projektit dhe Grupit të Menaxherëve ka qenë i dobët.**

Paraqitja përpara Bordit (PO/PB 10.00 “Për huadhënien për investime—nga identifikimi deri në paraqitjen para Bordit”)

42. *Grupi i Menaxherëve nuk e ndreqi përmendjen e gabuar të moratoriumit në DVP gjatë mbledhjes së Bordit, të zhvilluar më 21 qershor 2005, edhe atëherë kur anëtarët e Bordit e mirëpritën marrëveshjen e pretenduar, në deklaratat me shkrim të tyre.* Ekipi i Projektit dhe Shefi i Sektorit përgjegjës për Projektin ishin në dijeni të faktit që Qeveria nuk kishte rënë dakord për një moratorium dhe projekt-Deklarata Hapëse ishte ndryshuar një natë përpara diskutimeve në Bord, për të pranuar gabimin në DVP. Mirëpo, ata nuk e ngritën këtë problem me rëndësi kritike në mbledhjet që i paraprinin mbledhjes së Bordit, me Nënpresidentin Rajonal dhe Drejtorin e Vendit. Fjalitë përkatëse u hoqën nga deklaratat nga stafi drejtues i lartë për EAQ-në në sallën e Bordit, vetëm pak përpara se të lexohej deklaratat. Disa prej anëtarëve të Ekipit të Projektit, të cilët e dinin se nuk ekzistonte asnjë moratorium morën pjesë në mbledhjen e Bordit me një kopje të shtypur në letër të deklaratës në të cilën përfshihej një paragraf ku pranohej dhe ndreqej ky gabim, por ata nuk e vunë re që kjo pjesë me rëndësi kritike nuk u lexua. Për pasojë, ata vijuan të besojnë se ishte ndrequr gabimi, deri në çastin kur këtë problem e ngriti Paneli i Inspektimit, më shumë se dy vjet më pas. Stafi drejtues për vendin dhe sektorin nuk shfrytëzuan asnjë mundësi tjetër për ta ndrequr këtë gabim kur aprovuan “Përmbledhjen e Deklaratës së Bordit”, edhe pse këtë deklaratë e kaluan persona, të cilët e dinin se nuk ekzistonte asnjë moratorium. **Madje, këto ngjarje të pavolitshme përpara dhe gjatë mbledhjes së Bordit nuk u diskutuan më pas nga Grupi i Menaxherëve të Rajonit dhe nuk u ndërmor asnjë masë për ta ndrequr gabimin në DVP deri në çastin kur këtë gabim Grupit të Menaxherëve ia sollli në vëmendje Paneli i Inspektimit.**

Mbikëqyrja e Projektit (PO/PB 13.05 “Mbikëqyrja e Projekteve”)

43. *Rreziqet që shoqërojnë programin në zbatim e sipër të Qeverisë për prishjen me detyrim të objekteve, si për popullatën e zonës së Projektit ashtu edhe për reputacionin e Bankës Botërore, vazhduan edhe gjatë fazës së mbikëqyrjes së Projektit.* Raportet mbi statusin e zbatimit për Projektin kanë dalë vetëm një herë në vit, që nuk mjafton për projektet komplekse me rrezik. As Ekipi i Projektit, që përgatit raportet e statusit të zbatimit, as Shefi i Sektorit, që i kundërfirmoste këto raporte, dhe as Shefi i Zyrës në Vend, që jepte komentet për këto projekte, nuk i ngritën rreziqet që shoqëronin programin në zbatim e sipër të Qeverisë për prishjen e objekteve. Siç e ka nënvizuar Paneli i Inspektimit, përgatitja e PZHBJ-së dhe përcaktimi i një pakete asistence për të varfrit dhe grupet vulnerabël të prekur nga prishja e objekteve që mund të ndodhte pas përfundimit të PZHBJ-së dhe planeve vendore rregulluese është vonuar me më shumë se dy vjet. **Ekipi i Projektit dhe Grupi i Menaxherëve duhet ta kishin pranuar se kjo vonesë i ka rënduar rreziqet që shoqëronin programin në zbatim e sipër për**

prishjen e objekteve, dhe duhet ta kishin ngritur këtë problem në raportet e statusit të zbatimit dhe masat e duhura të ishin diskutuar dhe zbatuar.

44. ***Gjykimi i dobët nga Grupi i Menaxherëve ka çuar në një perceptim të konfliktit të interesit.*** Në fillim të vitit 2006, Qeveria e Shqipërisë ndërmori një proces konkurrues për të përzgjedhur Koordinatorin e Projektit. Kandidati i përzgjedhur si personi më i kualifikuar teknikisht ishte dhëndri i kryeministrit. Në ndjekje të udhëzimeve të Këshilltarit Rajonal për Prokurimet, Grupi i Menaxherëve mori garanci se procesi i përzgjedhjes nuk ishte ndikuar nga marrëdhënia e lartpërmendur dhe se do të mbahej një distancë raportimi midis Koordinatorit të Projektit dhe Kryeministrit. Më pas, Grupi i Menaxherëve dha moskundërshtimin për përzgjedhjen e Koordinatorit të Projektit. Në vend që ta trajtonte këtë emërim si çështje prokurimi rutinë, **Grupi i Menaxherëve duhet ta kishte gjykuar më mirë këtë çështje, duke pasur parasysh se një emërim i tillë do të krijonte, të paktën, perceptimin e një konflikti interesi dhe, rrjedhimisht, do të lindte një rrezik reputacioni për Bankën Botërore.** Kur Paneli i Inspektimit e ngriti çështjen e perceptimit të konfliktit të interesit në fillim të vitit 2008, Grupi i Menaxherëve mendoi se nuk kishte asnjë bazë juridike për ta trajtuar këtë çështje. Megjithatë, pretendimet e ngritura në Kuvendin e Shqipërisë dhe në mjetet e komunikimit në verën e vitit 2008 në lidhje me Koordinatorin e Projektit dhe bashkëshorten e tij u diskutuan me Qeverinë dhe iu kaluan për shqyrtim Departamentit të Integritetit Institucional të Bankës Botërore.¹¹

45. ***Ngaqë Ekipi i Projektit nuk i vlerësoi rreziqet që shoqëronin prishjen e objekteve, paçka se këto rreziqe qenë identifikuar në DVP, ai nuk mundi të jepte një orientim adekuat për Njësinë shqiptare të Koordinimit të Projektit sa i takon përcjelljes së fotografive ajrore të financuara nga Projekti.*** Këto foto kishin për synim monitorimin e ndërtimeve të paligjshme në Bregdetin Jugor dhe dhënien e ndihmës Policisë së Ndërtimit që kjo e fundit të merrte masa parandaluese në fazat e para fare të ngritjes së paligjshme të ndërtimeve të reja. Mirëpo, **Ekipi i Projektit duhet t'ia kishte sqaruar Njësisë shqiptare të Koordinimit të Projektit se fotografitë nuk duhet të ishin përdorur si mjet për të vënë në shënjestër objektet ekzistuese që duheshin prishur.**

46. ***Duke mos reaguuar në kohë për prishjen e objekteve të muajit prill 2007, Grupi i Menaxherëve i dha mundësi opinionit publik ta lidhte prishjen e objekteve me Projektin dhe, rrjedhimisht, me Bankën Botërore.*** Prishja e objekteve në Jalë u bë nga data 17 prill deri më 21 prill 2007. Ekipi i Projektit, për herë të parë, mësoi për këtë aksion përmes mjeteve të komunikimit më 18 prill 2007 dhe kontaktoi Njësinë shqiptare të Koordinimit të Projektit më 19 prill 2007. Po atë ditë, Ekipit të Projektit i erdhi një kopje e letërkëmbimit të datës 26 mars 2007 midis Njësisë shqiptare të Koordinimit të

¹¹ Pas kësaj, INT shqyrtoi të gjithë dokumentacionin në dispozicion dhe u takua me personelin operativ për të konstatuar nëse përligjej apo jo një investigim. Edhe pse informacionet në dispozicion lënë të kuptosh se ka, të paktën, konflikt interesi në dukje nga përzgjedhja e Koordinatorit të Projektit, nuk u paraqit asnjë informacion që të përbënte bazë të mjaftueshme për të hetuar më tej një praktikë të sanksionueshme siç përcaktohet nga normat e Bankës. Rrjedhimisht, në zbatim të praktikës standarde, INT e hodhi poshtë kërkesën për ta ndjekur më tej këtë çështje. INT vërente se edhe sikur të ishte ndërmarrë një investigim dhe sikur të ishin konstatuar praktika të sanksionueshme, INT do t'ua kishte kaluar çështjen në fjalë autoriteteve shqiptare për ta ndjekur më tej.

Projektit dhe Policisë së Ndërtimit (shih paragrafin 32). Zonën e vizitoi një “Mision fakt-mbledhës”, i përbërë nga Drejtuesi i Ekipit të Projektit dhe Eksperti Social i Ekipit të Projektit, më 3-5 maj 2007. Siç e thekson edhe Paneli i Inspektimit, misioni nuk arriti t'i kalojë Grupit të Menaxherëve informacione me rëndësi kritike, sidomos sa i takon ekzistencës së letërkëmbimit midis Njësisë shqiptare të Koordinimit të Projektit dhe Policisë së Ndërtimit. **Duket se Ekipi i Projektit nuk e ka vlerësuar rëndësinë e gjuhës që përmbante letërkëmbimi në fjalë. Pas “Misionit fakt-mbledhës”, për disa muaj nuk u tregua asnjë vëmendje për familjet e prekura nga prishja e objekteve e muajit prill 2007. U protokollua një letërkëmbim me Kërkuesit, që i është përcjellë edhe Shefit të Zyrës në Vend dhe Shefit të Sektorit, por që nuk mori asnjë përgjigje. Menaxherët për vendin nuk i korrigjuan raportet e gabuara të mediave lokale.**

Përgjigjja e Grupit të Menaxherëve e muajit shtator 2007

47. *Grupi i Menaxherëve pajtohet me Panelin e Inspektimit se Përgjigjja e Grupit të Menaxherëve e përgatitur në muajin shtator 2007 nuk ishte e vlefshme, nuk ofronte informacion dhe binte ndesh me informacionet faktike, të cilat duhet të ishin në dijeni të Grupit të Menaxherëve.* Përgjigjja e përgatitur ritheksonte gjykimin e Grupit të Menaxherëve, të arritur gjatë përgatitjes së Projektit, se PO/PB 4.12 nuk aplikohet as për veprimtaritë e rregullimit të territorit të Projektit as për programin në zbatim e sipër të Qeverisë për prishjen e objekteve. Mirëpo, **Raporti në fjalë nuk trajtonte faktet, të cilat kishin dalë gjatë vënies në zbatim të Projektit dhe që kishin futur paqartësi sa i takon këtij vendimi në lidhje me politikën. Në veçanti, në Përgjigje nuk trajtohej letërkëmbimi midis Koordinatorit të Projektit dhe Policisë së Ndërtimit, që i kishte paraprirë prishjes së objekteve të muajit prill 2007. Gjithashtu, në Raport nuk përmendej dhe nuk merrej parasysh se në DVP përmendej gabimisht ekzistenca e një moratoriumi.** Personat që e hartuan Përgjigjen e vunë re gabimin në DVP, po ata morën garanci se ky gabim ishte ndrequr gjatë mbledhjes së Bordit nga një punonjës që kishte marrë pjesë në mbledhjen e Bordit dhe kishte vazhduar të besonte se gabimi që ndrequr në deklaratën hapëse (shih paragrafin 42). Ekipi i Projektit, i cili nuk e kishte vlerësuar asnjëherë rëndësinë e letërkëmbimit midis Koordinatorit të Projektit dhe Policisë së Ndërtimit, nuk e përmendi ekzistencën e tij në kohën kur është hartuar Përgjigjja e Grupit të Menaxherëve.

Korrigjimi i gabimit në DVP në muajin shtator 2008

48. *Grupi i Menaxherëve pajtohet me Panelin e Inspektimit se nxjerrja e një Korrigjimi në muajin shtator 2008 nuk mjaftonte për të ndrequr gabimin në DVP, në lidhje me ekzistencën e një moratoriumi për prishjen me detyrim të objekteve.* Natyrisht, ky gabim duhet të ishte ndrequr në kohën e miratimit të Projektit nga Bordi, në muajin qershor 2005. Një gjë e tillë nuk ndodhi, për shkak të arsyeve të parashtruara më lart. Po të kemi parasysh se anëtarët e Bordit e kishin thënë shprehimisht se ndjeheshin mirë që ekzistonte një moratorium, në kohën e miratimit të Projektit, duke marrë në konsideratë faktin se mungesa e një moratoriumi ishte një e metë me rëndësi kritike në skemën e projektit dhe duke pranuar se tri vjet kanë kaluar prej miratimit të Projektit nga Bordi, **Grupi i Menaxherëve e pranon se mënyra e trajtimit të këtij gabimi të kësaj shkalle duhet të ishte diskutuar me Bordin.** Për më tepër, duke qenë se po zhvillohej

një investigim nga Paneli i Inspektimit, Grupi i Menaxherëve duhet të ishte konsultuar me Panelin e Inspektimit, përpara se të vepronte.

49. ***Duke pasur parasysh rëndësinë e gabimeve të identifikuarra për Projektin, Presidenti i Bankës Botërore i ka kërkuar Këshilltarit të Përgjithshëm në detyrë të kryejë një shqyrtim të rrethanave që lidhen me nxjerrjen e Korrigjimit të muajit shtator 2008. Në bazë të këtij shqyrtimi, Presidenti i ka kërkuar Departamentit për Integritet Institucional të Bankës Botërore të drejtojë një Analizë të Llogaridhënies, për keqparaqitjen e pretenduar të informacionit përpara Panelit të Inspektimit dhe për ngjarjet që lidhen me përgatitjen e Projektit, paraqitjen përpara Bordit dhe mbikëqyrjen e Projektit.***

C. ASISTENCA PËR PERSONAT E PREKUR NGA PRISHJA E OBJEKTEVE NË PRILL 2007

50. Grupi i Menaxherëve i ka kërkuar Qeverisë së Shqipërisë t'i dëmshpërblejë Kërkuesit për dëmet në objektet e tyre. Në përgjigjen e saj, Qeveria i qëndron mendimit se prishja e objekteve është bërë në përputhje me ligjet e veta dhe në kuadër të një programi, i cili fillimet i ka në mes të viteve '90. Programi në fjalë i Qeverisë ka për synim mbajtjen në kontroll të ndërtimit të parregulluar në gjithë Shqipërinë. Qeveria mendon se dëmshpërblimi do të ishte një shtysë negative dhe do të përbënte një trajtim të pabarabartë të Kërkuesve në raport me qytetarët e tjerë të prekur nga prishje objektesh. Për më tepër, Qeveria thekson se nuk ka qenë asnjëherë dakord për një skemë projekti, e cila të përfshinte një moratorium apo aplikimin e PO/PB 4.12 për programin në zbatim e sipër të Qeverisë për prishjen e objekteve.

51. Megjithatë, Qeveria e Shqipërisë ka rënë dakord sa më poshtë: (a) asistencë për ata Kërkues që janë të varfër dhe/ose vulnerabël; (b) një shqyrtim në kohë, të pavarur, të monitoruar e rast pas rasti në sistemin gjyqësor shqiptar, të pretendimeve të Kërkuesve, ku thonë se kanë pësuar dëme si rezultat i prishjes së objekteve në prill 2007 dhe se duhet të kompensohen si rezultat i prishjes së këtyre objekteve; dhe (c) Banka Botërore të financojë shërbimet juridike që u nevojiten Kërkuesve, përfshirë edhe apelimet e bazuara, pas përfundimit të shqyrtimit, nëse është e nevojshme.

52. ***Asistenca për personat e varfër dhe/ose vulnerabël.*** Në kuadër të përpjekjeve për të nxitur korrektësinë sociale të Projektit, do të përcaktoheshin, si pjesë e Vlerësimit Social dhe të Prekshmërisë, kriteret dhe procedurat për të asistuar personat e prekur (në përgjithësi) të cilët kanë humbur banesën parësore ose burimin kryesor të mjeteve të jetesës. ***Qeveria e Shqipërisë do t'u ofronte një paketë asistence atyre Kërkuesve të cilët konsiderohen si të varfër dhe/ose në pozita të cenueshme,¹² sipas kriterëve.*** Vlerësimi Social dhe i Prekshmërisë do të shqyrtojë prekshmërinë në disa dimensione,

¹² Të dhënat paraprake tregojnë se prekshmëria përgjatë bregdetit të jugut është e pranishme në disa pista. Janë të dukshme disa modele, të cilat do t'i bënin familjet në pozita sidomos të cenueshme në rast të prishjes së ndërtimeve, veçanërisht ato familje anëtarët e të cilëve emigrojnë për të punuar jashtë duke lënë pas disa anëtarë të familjes, në rastin kur përdoren të ardhurat nga emigrimi për të krijuar pasuri në formën e ndërtimeve dhe në rastin kur disa ndërtesa shërbejnë qoftë si banesë parësore ashtu edhe si burim për mjete jetese përmes të ardhurave nga qiraja. Modele të tilla, përfshirë edhe strategjitë shumë-brezore, ekzistojnë krah për krah me spekulimin nga ana e ndërtuesve, duke krijuar, kështu, bashkësi heterogjene.

përfshirë edhe rolin që kanë luajtur pasuritë e ndërtruara si banesa parësore si edhe si burime të mjeteve të jetesës. Në veçanti, përkufizimi i prekshmërisë (vulnerabël/pozitave të cenueshme) do të marrë në konsideratë kursimet (apo borxhet e marra), të cilat do të humbnin nëse do të prisheshin këto ndërtesa. Asistenca për personat e varfër dhe/ose në pozita të cenueshme do të paguhej nga burimet e veta buxhetore të Qeverisë.

53. ***Ofrimi Kërkuesve i mundësisë për të përfituar nga shqyrtimi juridik. Qeveria e Shqipërisë është angazhuar për një shqyrtim ligjor të drejtë dhe transparent për të përcaktuar çdo përgjegjësi ligjore që mund të ketë ardhur nga aplikimi i gabuar i legjislacionit shqiptar.*** Qeveria ka lënë të kuptojë se është e gatshme të mundësojë një proces në të cilin të mund të nisë dhe të përfundojë në kohë një shqyrtim i tillë.¹³ Në këtë kuadër, Qeveria do t'i informonte zyrtarisht Kërkuesit për të drejtën e tyre për të depozituar ankesë kundër ligjshmërisë së prishjes së objekteve dhe për të kërkuar dëmshpërblim. Shqyrtimi ligjor do të niste menjëherë dhe Qeveria do të bënte të gjitha përpjekjet për të siguruar përfundim të përsheptuar. Në ato raste në të cilat do të konstatohej se prishja e objekteve është e paligjshme, Qeveria do të jepte dëmshpërblim për pasuritë e humbura. Për më tepër, shqyrtimi ligjor do të mundësonte paraqitjen e ankesave në lidhje me dëmtime apo humbje të tjera të lidhura me prishjen e objekteve apo në lidhje me mënyrën se si është bërë prishja e objekteve, që, në varësi të legjislacionit të zbatueshëm shqiptar, mund të çonte në dhënien e dëmshpërblimeve të tjera shtesë. Çdo dëmshpërblim i njohur do të paguhej nga burimet e veta buxhetore të Qeverisë.

54. Banka Botërore do të kujdeset që Kërkuesit të përfaqësohen nga avokatë të kualifikuar si duhet, gjatë gjithë procesit të shqyrtimit. Për më tepër, për të siguruar transparencën dhe integritetin e shqyrtimit ligjor, Qeveria e Shqipërisë ka lënë të kuptojë se është e gatshme të ngrëjë një mekanizëm të pavarur të kontrollit mbikëqyrës, në formën e një ose më shumë vëzhguesish të paanshëm, të pranueshëm për Bankën Botërore. Për të siguruar paanshmërinë, kostot e mekanizmit të kontrollit mbikëqyrës dhe të asistencës ligjore do të financohen nga buxheti administrativ i Rajonit të EAQ-së.

55. Banka do të konfirmojë garancinë e Qeverisë se do të bëhen të gjitha përpjekjet e mundshme për përfundimin e përsheptuar të këtij shqyrtimi gjyqësor, duke njohur, në të njëjtën kohë, dhe duke u angazhuar për të respektuar tërësisht pavarësinë e gjyqësorit. Banka do të konfirmojë edhe që Qeveria do të ofrojë të gjithë dokumentacionin që ka në dispozicion, të nevojshëm për shqyrtimin gjyqësor, dhe që Qeveria nuk do të ketë kundërshtim për një propozim të arsyeshëm për bashkimin në një çështje të padive të Kërkuesve. Më tej, Banka do të konfirmojë edhe që Qeveria do të respektojë dhe do të përmbushë menjëherë të gjithë vendimet e gjykatës, të dala nga procesi i shqyrtimit gjyqësor, përfshirë edhe çdo vendim për t'i dëmshpërblyer paditësit. Nëse procesi gjykohet si i pakënaqshëm nga vëzhguesi apo nga Banka, Grupi i Menaxherëve rezervon opsionin (i) t'i pezullojë lëvrimet e fondeve në kuadër të Projektit të ristrukturuar, nëse hiqet pezullimi i tanishëm dhe ristrukturohet Projekti; dhe (ii) pavarësisht vendimit për ta

¹³ Shqyrtimi ligjor mund të fillojë me një shqyrtim administrativ paraprak. E drejta për t'u ankuar në rrugë gjyqësore do të ishte e mundshme përmes shqyrtimit administrativ.

anuluar apo ristrukturuar Projektin, t'u ofrojë asistencë Kërkuesve, edhe pse Banka nuk ka detyrimin ligjor për ta bërë një gjë të tillë.

56. **Bashkësitë e tjera të prekura.** Banka Botërore po heton për prishjet e tjera të objekteve që mund të kenë ndodhur gjatë muajit prill 2007 në zonën e Projektit dhe që mund të jetë të lidhura me veprimet e paautorizuara të Njesisë shqiptare të Koordinimit të Projektit. Grupi i Menaxherëve është në dijeni nga informacioni që ka marrë nga Qeveria se aksioni për prishjen e objekteve i muajit prill 2007 përfshinte gjashtë bashkësi të bregut të jugut (në të cilat janë prishur, përafërsisht, edhe 35 objekte të tjera, veç atyre të Jalës). Do të informoheshin edhe familjet e tjera të prekura nga prishja e objekteve e muajit prill 2007, se do t'u jepeshin të njëjtat të drejta.

D. OPSIONET NË SHQYRTIM

57. Sikurse përshkruhet më lart, Grupi i Menaxherëve e pranon se ka pasur mangësi të rënda gjatë përgatitjes, vënies në zbatim dhe mbikëqyrjes së Projektit. Një zbatim me sukses i Projektit kërkon ndryshime, për të trajtuar pasojat e gabimeve të shkuara dhe për të zbutur rreziqet ekzistuese. Për këtë qëllim, Grupi i Menaxherëve është përfshirë në diskutime të gjera me Qeverinë e Shqipërisë, për të rënë dakord për tri kushte thelbësore: (a) një paketë asistencë për personat e prekur nga prishja e objekteve e muajit prill 2007 në zonën e Projektit; (b) një kuadër masash për përmirësimin e vënies në zbatim të Projektit, përfshirë një pezullim të prishjes së ndërtimeve ekzistuese në zonën e Projektit deri në përmbushjen e kushteve konkrete; dhe (c) futjen e dy kushteve të para në Marrëveshjen e ndryshuar të Kredisë për Zhvillim, si pjesë e ristrukturimit të Projektit.

58. Grupi i Menaxherëve i njeh dhe i vlerëson përpjekjet e Qeverisë së Shqipërisë për të mbyllur elementet e parashtruara më lart. Mirëpo, Qeveria e Shqipërisë e ka informuar Grupin e Menaxherëve se nuk është e gatshme, për momentin, të bëjë shtesa dhe ndryshime në Marrëveshjen e Kredisë, për të pasqyruar pezullimin e prishjes së ndërtimeve ekzistuese, hap, të cilin Grupi i Menaxherëve e konsideron thelbësor për të siguruar që Projekti të ketë një bazë ligjore të shëndoshë për vënien në zbatim me sukses të tij. Në mungesë të një ndryshimi të tillë, që do të ishte i nevojshëm për t'u kujdesur që Projekti të mund të realizohet në përputhje me objektivat zhvillimor të deklaruar, më 9 janar 2009 Projekti është pezulluar.

59. Projekti mbetet i pezulluar, deri në arritjen e një vendimi për njërin prej dy opsioneve. Opsioni 1 konsiston në anulimin nga ana e Grupit të Menaxherëve, të gjithë Kredisë së SHNZH-së; Opsioni 2 propozon që, në bashkërendim me donatorët e tjerë, të ristrukturohet Projekti për të ruajtur mbështetjen për aktivitetet e mëposhtme: (i) pastrimi i mbetjeve të rrezikshme në Porto-Romano; (ii) ndërtimi i një vend-groposjeje për mbeturinat (*landfill*) dhe përgatitja e një sistemi të administrimit të mbetjeve të ngurta; (iii) ndërtimi i një terminali të udhëtarëve në Portin e Sarandës; (iv) investime në shkallë të vogël në ujësjellës-kanalizime në qytetin e Sarandës dhe në fshatrat e vegjël të Bregdetit të Jugut; (v) investime me bazë komunitetin në fshatrat bregdetare; dhe (vi) administrimi i zonave të mbrojtura të Parkut Kombëtar të Butrintit.

60. Në rast të një ristrukturimi të tillë, duke pasur parasysh se nuk është arritur një marrëveshje në lidhje me pezullimin e prishjes së ndërtimeve ekzistuese, që do të ishte pasqyruar në një Marrëveshje ligjore të ndryshuar, të gjitha aktivitetet e rregullimit të territorit do të anulohen dhe fondet për to do t'u shpërndahen aktiviteteve të tjera. Gjatë ristrukturimit të Projektit, pezullimi i lëvrimin të fondeve do të ndërpritej për të gjitha veprimtaritë me përjashtim të atyre të rregullimit të territorit, për të siguruar vijimin e zbatimit të investimeve të rëndësishme në infrastrukturë.

61. **Mbikëqyrje e përmirësuar.** Janë bërë dhe/ose do të bëhen hapa të shumtë, për të fuqizuar mbikëqyrjen e Projektit. Në mars 2008, është futur në Ekipin e Ngarkuar me Projektin një ekspert i lartë për çështjet sociale, me përvojë të gjerë rajonale, për të trajtuar çështjet e lidhura me prishjen e objekteve e muajit prill 2007. Eksperti i lartë për çështjet sociale do të shërbejë si ndërlidhësi kryesor për Bankën Botërore me banorët e Jalës, sa i takon ofrimin të asistencës të mbështetur nga Projekti. Eksperti i lartë për çështjet sociale do të mbikëqyrte edhe Vlerësimin Social dhe të Prekshmerisë.

62. Është përfshirë në Ekipin e Projektit një jurist i nivelit të lartë, i cili do të mbikëqyrë çështjet juridike dhe institucionale. Është marrë në punë një kryespecialist mjedisor për Rajonin e EAQ-së, për të siguruar faktorin udhëheqës në lidhje me administrimin e ndotjes, për të nxitur qeverisjen mjedisore, për të administruar disa operacione të përzgjedhura të rëndësishme të veçantë dhe për të këshilluar punonjësit që punojnë me operacionet e administrimit mjedisor. Kryespecialisti mjedisor do të përfshihej në Ekipin e Projektit për të siguruar zbatimin me cilësi dhe në kohë të Projektit.

63. Së fundmi, do t'i jepeshin burimet e mjaftueshme Ekipit të Projektit të Bankës Botërore, për të realizuar mbikëqyrjen e përmirësuar të Projektit. Burimet për mbikëqyrjen për Projektin janë rritur nga 80.000 USD në vitin fiskal 2007 në 190.000 USD në vitin fiskal 2009 dhe do të mbeteshin në të njëjtin nivel gjatë kohës së mbetur të Projektit.

E. ADMINISTRIMI I PORTOFOLIT

64. **Administrimi i portofolit për EAQ-në.** Në dritën e gabimeve të përshkruar më lart, stafi i lartë drejtues për regjionin EAQ ka nënvizuar për të gjithë administratorët e sektorëve dhe drejtuesit e ekipeve të projekteve se prej tyre kërkohet fuqimisht llogaridhënia për cilësinë dhe vërtetësinë e informacionit në DVP. Të gjitha Drejtoritë e Sektorëve, rrjedhimisht, i kanë rishikuar procedurat e brendshme të tyre dhe personelin e tyre, për të siguruar cilësinë. Në veçanti, janë vendosur procedura për tu kujdesur që të mos jepet leje për asnjë dokument pa bërë një shqyrtim të plotë dhe janë marrë masat për të siguruar praninë e administratorëve të projekteve në mbledhjet për konceptimin dhe marrjen e vendimeve të projekteve. Veç kësaj, **janë shqyrtuar të 302 projektet e portofolit të rajonit EAQ, për të identifikuar ndonjë mospërputhje në dokumentacionet e projekteve dhe ndonjë ndryshim të bërë gjatë zbatimit, i cili do të kërkonte ristrukturim të projektit. Ky shqyrtim nuk ka identifikuar asnjë projekt me probleme të kësaj shkalle të rëndë, të konstatuar në këtë Projekt.** Përveç këtij Projekti, janë identifikuar dhe do të korrigjohen edhe katërmbëdhjetë raste me

mospërputhje në dokumentacion. Janë identifikuar tridhjetekatër raste ku janë bërë ndryshime gjatë vënies në zbatim. Disa syresh janë pasuar tashmë me ristrukturim projekti, ndërsa të tjerët po sqarohen për të parë nëse është apo jo i nevojshëm ristrukturimi i projektit. Stafi drejtues për rajonin e EAQ-së do të kujdeset që Banka Botërore të marrë të gjitha masat brenda autoritetit të vet për t'i trajtuar këto çështje brenda datës 30 qershor 2009. Veç kësaj, stafi drejtues për rajonin e EAQ-së ka nisur një seri seminaresh pune rajonale mbi masat mbrojtëse, për të rritur kapacitetet e personelit në lidhje me identifikimin e rreziqeve sociale në hartimin dhe mbikëqyrjen e projekteve, si edhe në lidhje me masat mbrojtëse sociale.

65. Stafi i lartë drejtues i Bankës Botërore e ka zgjeruar këtë proces shqyrtimi, për të përfshirë përafërsisht 1.550 projektet e portofolit të saj, si edhe kuadrin organizativ për kontrollin e cilësisë në të gjitha Rajonet. Rezultatet e plota të këtij Shqyrtimi dhe veprimet e propozuara për fuqizimin e kontrollit të cilësisë dhe trajnimin operativ të drejtuesve të ekipeve të projekteve do t'i raportohen Bordit në kohën kur do të diskutohet kjo Përgjigje e Grupit të Menaxherëve.

66. **Administrimi i portofolit për Shqipërinë.** Si pjesë e funksionit të saj për administrimin e portofolit, Zyra e Bankës Botërore në Tiranë të Shqipërisë, me ndihmën e POSHV-së dhe LEG-së, do të realizojë një seminar pune me personelin e projekteve dhe zyrtarë të qeverisë për të diskutuar për masat mbrojtëse mjedisore dhe sociale të Bankës Botërore, ligjet shqiptare dhe marrëdhënien midis këtyre të dyjave në kuadër të projekteve të financuara nga Banka Botërore. Seminari në fjalë do të përfshijë raste studimore nga projekte të shkuara dhe aktuale dhe do të nxjerrë në pah mësimet e nxjerra. Ai do të përsëritet në të ardhmen, sipas nevojës, duke ndjekur shinat e trajnimit të ngjashëm që ofrohet tashmë për udhëzuesit për prokurimet dhe drejtimin financiar.

67. **Komunikimi jashtë zyrës së Bankës në Shqipëri.** Në muajin dhjetor 2007, Zyra e Bankës Botërore në Tiranë të Shqipërisë e ka rishikuar strategjinë e vet për komunikimin, në dritën e çështjeve të ngritura gjatë investigimit të Panelit të Inspektimit. Ndër të tjera, strategjia e re përfshin: (a) një sistem për përgjigje parapritëse dhe me afate kohore të përcaktuara kundrejt ankesave të ardhura nga komunitetet, shoqëria civile dhe sektori privat; (b) sesione informuese vjetore për komisionet përkatëse parlamentare në lidhje me zbatimin e projekteve dhe çështjet e reformave të politikave; dhe (c) rritje të mbikëqyrjes së proceseve të konsultimeve të udhëhequra nga qeveria gjatë përgatitjes dhe zbatimit të projekteve, përfshirë edhe mbikëqyrjen e përmbushjes së angazhimeve të Qeverisë së Shqipërisë në kuadër të Konventës së Arhusit. Strategjia përfshin edhe një shqyrtim vjetor të nevojave të komunikimit për secilin projekt të financuar nga Banka Botërore në Shqipëri.

V. MËSIMET E NXJERRA

68. Nga çështjet e ngritura në seksionet e më sipërme mund të nxirren disa mësimet kyçe. Në këtë seksion nënvizohen këto mësimet dhe sugjerohen mjetet për trajtimin e problemeve të lindura gjatë përgatitjes së Projektit, paraqitjes përpara Bordit dhe mbikëqyrjes së Projektit.

LLOGARIDHËNIA, PËRGJEGJËSIA DHE KONTROLI MBIKËQYRËS

69. *Një mësim madhor lidhet me nevojën që të gjithë, drejtues dhe punonjës të thjeshtë, të veprojnë në përputhje me përgjegjësitë e vendit të punës.* Grupi i Menaxherëve e pranon se janë bërë gabime në thuajse të gjithë hapat me rëndësi kritike të Projektit. As Grupi i Menaxherëve e as punonjësit e tjerë nuk i përmbushën përgjegjësitë e tyre me konsekuencë.

70. *Stafi drejtues i lartë lipset të kujdeset që njohuritë prej ekspertit dhe përvoja e drejtuesit të ekipit të ngarkuar me projektin dhe e anëtarëve të ekipit të ngarkuar me projektin të përputhet me shkallën e kompleksitetit të projektit dhe me objektin dhe shkallën e rreziqeve që e shoqërojnë atë. Grupi i Menaxherëve lipset të ushtrojë një kontroll mbikëqyrës që të jetë në përpjesëtim të drejtë me shkallën e kompleksitetit dhe me përvojën e drejtuesve të ekipeve të projekteve.* Projektet që janë po aq komplekse dhe me rrezik sa edhe ky Projekt duhet të kenë drejtues të ekipit të projektit dhe ekipe të projektit me shumë përvojë dhe me aftësinë për t'i diktuar dhe diskutuar çështjet dhe rreziqet kur të lindin, të kenë gjykimin për të kërkuar mendimin e ekspertëve sa herë lind nevoja, të kenë reaguuar siç duhet në të shkuarën kundrejt rrezikut që mund t'i jetë kanosur reputacionit të Bankës Botërore dhe të jenë të përkushtuar për t'iu përgjigjur publikut të vendeve anëtare. Sikur Projekti të kishte pasur një ekip projekti me më shumë përvojë dhe të ishte shërbyer nga misionet para-vlerësimi dhe vlerësimi të pajisura me staf të përshtatshëm, atëherë ka të ngjarë që çështjet komplekse të ishin trajtuar në mënyrë më adekuate. Edhe sikur të kishte ndodhur kështu, shefat e sektorëve duhet medoemos të bëjnë një monitorim të bollshëm dhe kontroll mbikëqyrës të ngushtë për operacionet tejet komplekse dhe me rrezikshmëri.

71. *Shefave të sektorëve duhet medoemos t'u kërkohet llogari për cilësinë gjatë gjithë ciklit të projektit.* Sikur të ishte bërë një shqyrtim i plotë dhe i imët përpara se të dorëzoheshin dokumentet e Projektit për negociata dhe për t'u shpërndarë anëtarëve të Bordit, ka të ngjarë të ishte kapur gabimi që ishte futur në DVP pas mbledhjes për marrjen e vendimit. Stafi drejtues për sektorin lipset të kujdeset që ekipet e ngarkuara me projektet të përmbushin standardet dhe procedurat institucionale (për shembull, të nxjerrin Promemorje, raporte për statusin e zbatimit). Stafi drejtuesi i sektorëve lipset t'i monitorojë nga afër projektet komplekse dhe/ose me rrezikshmëri dhe të ushtrojë kontroll mbikëqyrës mbi portofolët e tyre.

72. *Drejtuesit e ekipeve të projekteve duhet t'i ngrenë shqetësimet përpara Grupit të Menaxherëve në kohën e duhur.* Sikur Drejtuesi i Ekipit të Projektit ta kishte diskutuar rregullisht Projektin me shefin e sektorit dhe me Shefin e Zyrës në vend dhe me Drejtorin për Vendin dhe sikur t'ua kishte sjellë në vëmendje në mënyrë të qartë ndryshimet me rëndësi materiale me lindjen e tyre gjatë përgatitjes dhe mbikëqyrjes së Projektit, shumë prej problemeve do të ishin kapur dhe trajtuar në kohë. **Po kaq e rëndësishme, Grupi i Menaxherëve lipset të krijojë një kulturë, e cila të nxisë diskutimet për problemet dhe rreziqet në një mënyrë gjithëpërfshirëse, të plotë dhe transparente.** Stafi drejtues lipset të kujdeset që personelit t'i jepen kompetenca për t'ia sjellë në vëmendje çështjet me rëndësi kritike dhe mosmarrëveshjet, sipas nevojës. Po kështu, drejtuesit e ekipeve të

projekteve lipset të krijojnë një kulturë po aq gjithëpërfshirëse komunikimi brendapërbrenda ekipeve të tyre të ngarkuar me projektet.

TRAJTIMI I RREZIQEVE TË PROJEKTEVE

73. **Projektet komplekse kërkojnë ekipe të drejtimit të projektit që të kenë përvojë dhe një gamë të gjerë aftësish teknike, si edhe të jenë nën kontrollin mbikëqyrës të Grupit të Menaxherëve që të jetë intensiv dhe i vazhdueshëm.** Projekti ka shumë komponentë, që ndryshojnë nga njëri tjetri dhe janë kompleks dhe të cilët e kanë copëzuar vëmendjen e Grupit të Menaxherëve dhe të ekipit të ngarkuar me projektin. Stafi drejtues dhe punonjësit e zakonshëm duhet të jenë selektiv gjatë përgatitjes së projekteve, sidomos në vendet me kapacitete të ulëta. Po kështu, duhet evituar shtimi i komponentëve në fazat e fundit të përgatitjes së projekteve.

74. **Ekziston nevoja për t'i vlerësuar me kujdes rreziqet, përfshirë edhe ato që i kanosen reputacionit, që në fillim, për t'i identifikuar si duhet masat zbutëse dhe për t'i paraqitur rreziqet me hollësi dhe sinqeritet në dokumentet e projekteve. Drejtorët që mbulojnë vendet duhet t'i autorizojnë Vlerësimet dhe Negociatat vetëm pasi të jetë rënë dakord dhe të jetë dokumentuar një qasje e qartë për problemet dhe rreziqet kryesore.** Sikurse dokumentohet edhe në procesverbalin e Mbledhjes së Vendimit, Ekipi i Projektit urdhërohej t'i diskutonte çështjet e pazgjidhura me njësitë e specializuara të Bankës Botërore. Mirëpo, problemet as nuk u zgjidhën me sukses e as nuk u ndoqën me Grupin e Menaxherëve, i cili, megjithatë, autorizoi Vlerësimin dhe Negociatat. Kështu, ky Projekt i është paraqitur për miratim Bordit pa një debat të plotë, të hollësishëm, konkluziv dhe të dokumentuar për problemet dhe rreziqet e lidhur me të.

75. **U duhet kushtuar vëmendja e mjaftueshme rreziqeve sociale.** Projekti, edhe pse përqendrohet në rregullimin e territorit, tregon se cilësia dhe qëndrueshmëria e Projektit varet nga një vlerësim i kujdesshëm dhe zbutje e rreziqeve sociale. Në përputhje me praktikën e mirë, duhet të ishte konstatuar informacioni bazë shoqëror dhe ekonomik për momentin kur fillon projekti, sa u takon individëve të cilët mund të preken drejtpërdrejt ose tërthorazi nga Projekti. Për më tepër, duhej të ishin vlerësuar dhe zbutur rreziqet e shoqëruara me efektet e tërthorta të padëshiruara shoqërore ose ekonomike. Kjo duhej të ishte shoqëruar me një vlerësim të hollësishëm të problemeve të lidhura ligjore dhe institucionale. Stafi drejtues i sektorit dhe ekipi i ngarkuar me projektin janë përqendruar shumë ngushtë vetëm në faktin nëse aplikojnë apo jo PO/PB 4.12 në rastin e veprimtarive të rregullimit të territorit në kuadër të Projektit, duke mos vlerësuar dhe trajtuar, kështu, rreziqet sociale, sikurse rekomandon edhe politika.

76. **Kundërpalët duhet t'i kuptojnë tërësisht dhe të jenë në krye të procesit të masave për zbutjen e rreziqeve sociale.** Masat për zbutjen e rreziqeve sociale lipset të diskutohen me kundërpalët që në fillim të ciklit të Projektit, në mënyrë që të sigurohet se marrja e vendimeve nga kundërpalët dhe punonjësit e Bankës Botërore të jetë e bazuar në informacione. Për më tepër, kundërpalët lipset të kenë orientime të qarta si të vihen në zbatim masat për zbutjen e rreziqeve dhe si të mbikëqyren ato nga personeli i Bankës Botërore gjatë vënies në zbatim të Projektit.

77. ***Gjatë përpilimit të projekteve komplekse të planifikimit të përdorimit të tokës, është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje kuadrit ligjor dhe institucional.*** Përgatitja e projektit duhet të kishte përfshirë një vlerësim të hollësishëm të problemeve ligjore dhe institucionale.

78. ***Gjatë vënies në zbatim të projekteve, lipset të vlerësohen vazhdimisht rreziqet dhe të bëhen të ditur, me transparencë, në raportet e statusit të zbatimit, shqyrtimet e portofolëve dhe shqyrtimet e rreziqeve rajonale.*** Sikur Ekipi i Projektit dhe Grupi i Menaxherëve t'i kishte vlerësuar tërësisht rreziqet shtesë që shoqëronin vonesën e përgatitjes së PZHBJ-së, sikur t'i kishte paraqitur ato në raportet e statusit të zbatimit dhe sikur të kishte vepruar për t'i trajtuar si duhet ato, të metat në skemën e Projektit do të ishin ndrequr në kohë.

79. ***Është e rëndësishme të verifikohen faktet në terren dhe të komunikohen qartë dhe në kohë, përfshirë edhe në media.*** Kur ka raporte nga baza se ka probleme në një projekt të caktuar, këto probleme lipset të verifikohen në vend sa më shpejt të jetë e mundur nga Ekipi i Projektit, me mbështetjen e punonjësve të tjerë shtesë, sipas nevojës. Pas prishjes së objekteve të muajit prill 2007, Banka Botërore nuk u takua me personat e prekur për thuajse një vit. Po kështu, ajo nuk iu përgjigj një letre të dërguar nga njëri prej Kërkesve dhe nuk e shfrytëzoi mundësinë për t'i korrigjuar raportet e gabuara në median lokale. Zyra e Bankës Botërore në Tiranë, Shqipëri, ka vendosur tani udhëzues të qartë për t'iu përgjigjur menjëherë ankesave dhe kërkesave për informacion dhe ka një politikë parapritëse afruese me median.

KOMUNIKIMI ME BORDIN

80. ***Përgatitja për mbledhjet e Bordit duhet të jetë e hollësishme, duhen pranuar menjëherë dhe plotësisht gabimet dhe duhen trajtuar me shpejtësi problemet e pazgjidhura pas mbledhjes së Bordit.*** Mund të ishin evituar problemet e lidhura me gabimin në DVP nëse do të ishte përmendur gabimi në DVP në lidhje me moratoriumin, në mbledhjet me Nënpresidentin Rajonal dhe Administratorin Rajonal, nëse do të ishte pranuar në mbledhjen e Bordit dhe nëse do të ishte ndjekur kjo çështje menjëherë pas mbledhjes së Bordit.

81. ***Duhen ndjekur mënyrat e duhura të komunikimit me Bordin në rastet kur dokumentacioni i Projektit përmban gabime, të cilat lidhen me miratimin e Bordit.*** Po të kemi parasysh se anëtarët e Bordit e kanë përmendur shprehimisht moratoriumin mbi programin në zbatim e sipër të Qeverisë së Shqipërisë për prishjen me detyrim të ndërtimeve, në deklaratat e tyre me shkrim, dhe se kishin kaluar tre vjet nga miratimi i Projektit, Korrigjimi i Gabimit e muajit shtator 2008 nuk mjaftonte për ta ndrequr gabimin në DVP.

MËSIMET TË TJERA TË RËNDËSISHME

82. ***Përgjegjësia për përgatitjen e Përgjigjes së Grupit të Menaxherëve për një Kërkesë për Investigim nga Paneli i Inspektimit apo për një Raport Investigimi të Panelit të Inspektimit duhet t'i ngarkohet një drejtuesi të nivelit të lartë (në nivel***

drejtori). Ky person lipset të jetë i gatshëm për të ushtruar kontroll mbikëqyrës mbi procesin, duke qenë se këto detyra kërkojnë një nivel të konsiderueshëm përvojë institucionale, gjykimi dhe autoriteti vendimmarrës. Përgjigjja e Grupit të Menaxherëve e muajit shtator 2007, në lidhje me Kërkesën për Investigim, është përgatitur në mungesë të kontrollit mbikëqyrës të vazhduar të nivelit të lartë.

83. **Emërimet në nivel drejtues lipset të bëhen në kohë, për të evituar boshllëqet kohore në vijimësinë dhe rolin udhëheqës.** Përgjigjja e Grupit të Menaxherëve e muajit shtator 2007 vuante nga konsultimet dhe diskutimet e pamjaftueshme për shkak të qarkullimit dhe mungesës së personave në nivel drejtues. Kur ka mungesa në personelin e emëruar apo kur ka një numër mungesash të personave në nivel drejtues për shkak të misioneve, pushimeve, etj., duhet të ketë medoemos një sistem funksionues të personelit të komanduar (të përkohshëm), punonjës, të cilët duhet udhëhequr dhe mbështetur, sipas nevojës, nga shefi i sektorit dhe/ose drejtori për vendin.

84. **Emërimet në stafin e projekteve, të cilat paraqesin një konflikt të qenësishëm apo të perceptuar interesi nuk duhet të trajtohen si çështje rutinë prokurimi dhe duhen evituar, nëse është e mundshme.** Huamarrësi ka përgjegjësinë për ta përzgjedhur stafin e projekteve në përputhje me procedurat e prokurimit të Bankës Botërore. Megjithatë, Banka Botërore duhet të ushtrorë gjykimin e duhur në rastet e konfliktit të qenësishëm apo të perceptuar të interesit, siç është rasti kur përzgjidhen për t'u emëruar persona të afërm të zyrtarëve të lartë. Duhet evituar të gjitha rastet kur duket sikur ka konflikt interesi apo korrupsion.

VI. PLANI I VEPRIMEVE I GRUPIT TË MENAXHERËVE

85. Grupi i Menaxherëve e vlerëson raportin e Panelit të Inspektimit dhe është dakord me konstatimet kyçe të tij. Në tabelën në vijim paraqitet Plani i Veprimit në ndjekje të konstatimeve të Panelit të Inspektimit. Grupi i Menaxherëve do t'i raportojë Bordit për progresin në lidhje me Planin e Veprimit pas tre muajve.

Çështja që lidhet me Politikën Operative	MASA E PROPOZUAR
1. PO/PB 4.12 “SHPËRNGULJA E DETYRUAR”	
Aplikimi i PO/PB 4.12 për veprimtaritë e rregullimit të territorit	<p>1. Grupi i Menaxherëve do të ndërmarrë një shqyrtim të aplikimit të politikave mbrojtëse në projektet që mbështesin planifikimin e territorit (rregullimin e territorit). Në bazë të këtij shqyrtimi, Grupi i Menaxherëve do të përgatisë dhe shpërndajë: (a) një qartësim të politikës në lidhje me mënyrën se si aplikohet poshtëshënimi 8 i PO/PB 4.12 në rastin e projekteve të rregullimit të territorit; dhe (b) një dokument udhëzues sa i takon aplikimit të politikave mbrojtëse në projektet që mbështesin rregullimin të territorit. Dokumenti Udhëzues do të mbulojë si aplikimin e PO/PB 4.12 ashtu edhe përdorimin e masave të tjera për të trajtuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Qartësimi i politikës dhe Dokumenti Udhëzues do të dalin më 30 qershor 2009.</p> <p>2. Grupi i Menaxherëve do të shqyrtojë edhe aplikimin e politikave të masave mbrojtëse në rastet e veprimeve të paautorizuara të Njërive të Koordinimit të Projekteve dhe do të përgatisë dhe shpërndajë udhëzime</p>

Çështja që lidhet me Politikën Operative	MASA E PROPOZUAR
	<p>në lidhje me këtë çështje brenda datës 30 qershor 2009.</p> <p>3. Për punonjësit në të gjitha rajonet do të ofrohet trajnim i synuar, në mbështetje të aplikimit të këtij udhëzuesi.</p>
<p>Ofrimi i asistencës për Kërkuessit nga Jala</p>	<p>1. Banka do të financojë kostot e përzgjedhura për realizimin e një shqyrtimi rast pas rasti në sistemin gjyqësor shqiptar, të padive të Kërkuessve dhe pretendimeve të tyre se janë dëmtuar si rezultat i prishjes së objekteve në prill 2007 dhe se duhet të dëmshpërblehen si rezultat i prishjes së objekteve. Këto kosto do të përfshijnë shërbimet ligjore të kërkuara nga Kërkuessit, përfshirë këtu, nëse është e nevojshme, edhe për apelimet e bazuara pas gjykimit. Ato do të përfshijnë edhe pagesën e një vëzhguesi të pavarur, të pranueshëm për Bankën, i cili do t'i raportojë Bankës në lidhje me transparencën, besueshmërinë, pavarësinë dhe realizimin në kohë të procesit të gjykimit. Për t'i mundësuar këto veprime, Banka do të konfirmojë garancinë e Qeverisë se do të bëhen të gjitha përpjekjet e mundshme për përfundimin e përshpejtuar të këtij shqyrtimi gjyqësor, duke njohur, në të njëjtën kohë, dhe duke angazhuar për të respektuar tërësisht pavarësinë e gjyqësorit. Banka do të konfirmojë edhe që Qeveria do të ofrojë të gjithë dokumentacionin që ka në dispozicion, të nevojshëm për shqyrtimin gjyqësor, dhe që Qeveria nuk do të ketë kundërshtim për një propozim të arsyeshëm për bashkimin në një çështje të padive të Kërkuessve. Më tej, Banka do të konfirmojë edhe që Qeveria do të respektojë dhe do të përmbushë menjëherë të gjithë vendimet e gjykatës, të dala nga procesi i shqyrtimit gjyqësor, përfshirë edhe çdo vendim për t'i dëmshpërblyer paditësit. Nëse procesi gjykohej si i pakënaqshëm nga vëzhguesi apo nga Banka, Grupi i Menaxherëve rezervon opsionin (i) t'i pezullojë lëvrimet e fondeve në kuadër të Projektit, nëse do të ristrukturohej; dhe (ii) të ofrojë asistencë të drejtpërdrejtë për Kërkuessit, edhe pse, juridikisht, Banka nuk është e detyruar ta bëjë një gjë të tillë.</p> <p>2. Grupi i Menaxherëve do të mbikëqyrë kryerjen e Vlerësimit Social dhe të Prekshmërisë, në përputhje me termat e referencës për të cilat është rënë dakord me Bankën, si edhe zbatimin me fuqi propavepruese të paketës së asistencës që do të dalë prej tij për popullsinë e varfër dhe/ose në pozita të cenushme, për familjet e prekura nga prishja e objekteve në prill 2007.</p> <p>3. Grupi i Menaxherëve do t'i raportojë Bordit, pas tre muajsh, në lidhje me shqyrtimin gjyqësor rast pas rasti, si edhe në lidhje me Vlerësimin Social dhe të Prekshmërisë.</p>
<p>2. PO/PB 13.05 “MBIKËQYRJA E PROJEKTEVE”</p>	
<p>Vijimi i mbikëqyrje së Projektit</p>	<p>1. <u>Opsioni 1.</u> Grupi i Menaxherëve e anulon Kredinë e SHNZH-së. ose</p> <p>2. <u>Opsioni 2.</u> Në bashkërendim me donatorët e tjerë, Grupi i Menaxherëve do ta ristrukturojë Projektin për të ruajtur mbështetjen për aktivitetet e mëposhtme: (i) pastrimi i mbetjeve të rrezikshme në Porto-Romano; (ii) ndërtimi i një vend-groposje i mbeturinave (<i>landfill</i>) dhe përgatitja e një sistemi të administrimit të mbetjeve të ngurta; (iii) ndërtimi i një terminali të udhëtarëve në Portin e Sarandës; (iv) investime në shkallë të vogël në ujësjellës-kanalizime në qytetin e Sarandës dhe në fshatrat e vegjël të Bregdetit të Jugut; (v) investime me bazë komunitetin në fshatrat bregdetare; dhe (vi) administrimi i zonave të mbrojtura të Parkut Kombëtar të Butrintit. Do të anulohen të gjitha veprimtaritë e rregullimit të territorit dhe fondet e lidhura me to do</p>

Çështja që lidhet me Politikën Operative	MASA E PROPOZUAR
	<p>t'u rishpërndahen veprimtarive të tjera. Ristrukturimi i propozuar do t'i paraqitet Bordit për miratim. Gjatë ristrukturimit të Projektit, pezullimi i lëvrimit të fondeve do të hiqet për të gjitha veprimtaritë me përjashtim të atyre të rregullimit të territorit, për të siguruar vijimin e zbatimit të investimeve të rëndësishme në infrastrukturë.</p> <p>Shënim: Pavarësisht se për cilin prej Opsioneve 1 dhe 2 vendoset të zgjidhet, Banka synon t'u japë asistencë Kërkuesve, sikurse parashtrohet më lart.</p>
Trajtimi i çështjes së llogaridhënies së Grupit të Menaxherëve dhe stafit	<p>1. Duke pasur parasysh rëndësinë e gabimeve të identifikuara për Projektin, Presidenti i Bankës Botërore i ka kërkuar Këshilltarit të Përgjithshëm në detyrë të kryejë një shqyrtim të rrethanave që lidhen me nxjerrjen e Korrigjimit të muajit shtator 2008. Në bazë të këtij shqyrtimi, Presidenti i ka kërkuar Departamentit për Integritet Institucional të Bankës Botërore të drejtojë një Analizë të Llogaridhënies, për keqparaqitjen e pretenduar të informacionit përpara Panelit të Inspektimit dhe për ngjarjet që lidhen me përgatitjen e Projektit, paraqitjen përpara Bordit dhe mbikëqyrjen e Projektit.</p>
Forcimi i komunikimit	<p>1. Grupi i Menaxherëve do të vijojë të vendosë të zbatojë Strategjinë e Komunikimit të Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë, Shqipëri, të rishikuar rishtazi. Ndër të tjera, strategjia e re përfshin: (a) një sistem për përgjigje parapritëse dhe me afate kohore kundrejt ankesave të ardhura nga bashkësitë, shoqëria civile dhe sektori privat; (b) seanca vjetore informimi për komisionet përkatëse parlamentare në lidhje me zbatimin e projekteve dhe çështjet e reformave të politikave; dhe (c) rritje të mbikëqyrjes së proceseve të konsultimeve të udhëhequra nga qeveria gjatë përgatitjes dhe zbatimit të projekteve.</p>
Fuqizimi i masave mbrojtëse në portofolin në Shqipëri dhe EAQ	<p>1. Zyra e Bankës Botërore në Tiranë të Shqipërisë do të kryejë trajnim periodik për stafin e projekteve dhe qeveritarët, në lidhje me aplikimin e politikave të masave mbrojtëse të Bankës Botërore në rastin e projekteve të portofolit në Shqipëri.</p> <p>2. Staf i drejtues për regjionin e EAQ-së ka nisur një seri seminaresh pune rajonale mbi masat mbrojtëse, për të rritur kapacitetet e personelit në lidhje me identifikimin e rreziqeve sociale në hartimin dhe mbikëqyrjen e projekteve, si edhe në lidhje me masat mbrojtëse sociale.</p>
3. PO/PB 10.00 “HUADHËNIA PËR INVESTIME: NGA IDENTIFIKIMI DERI NË PARAQITJEN PËR BORDIN”	
Fuqizimi i kontrollit të cilësisë së përgatitjes së projekteve	<p>1. Staf i drejtues rajonal ka realizuar një shqyrtim të plotë të portofolit me 302 projekte në Regjionin e Evropës dhe Azisë Qendrore, për t'u dhënë zgjidhje shqetësimeve të ngritura në lidhje me cilësinë dhe saktësinë e Dokumenteve të Vlerësimit të Projektit, për t'u kujdesur që këto dokumente: (a) të pasqyrojnë si duhet marrëveshjet e arritura me Huamarrësin; (b) të japin përshtypjen e saktë për realitetin dhe perspektivën e projektit të propozuar; dhe/ose (c) të përfshijnë informacionet me rëndësi kritike. Grupi i Menaxherëve angazhohet t'i marrë të gjitha masat e duhura, brenda autoritetit të saj, për t'u dhënë zgjidhje këtyre problemeve brenda datës 30 qershor 2009.</p> <p>2. Staf i lartë drejtues i Bankës Botërore e ka zgjeruar këtë proces shqyrtimi, për të përfshirë përafërsisht 1.550 projektet e portofolit të saj, si edhe kuadrin organizativ për kontrollin e cilësisë në të gjitha Regjionet. Rezultatet e plota të këtij Shqyrtimi dhe veprimet e propozuara për fuqizimin e kontrollit të cilësisë dhe trajnimin operativ të drejtuesve të</p>

Çështja që lidhet me Politikën Operative	MASA E PROPOZUAR
	ekipeve të projekteve do t'i raportohen Bordit në kohën kur do të diskutohet kjo Përgjigje e Grupit të Menaxherëve.

VII. PËRFUNDIM

86. Janë të papranueshme gabimet dhe mosrespektimi i standardeve të punës të Bankës, që kanë çuar në shkeljet e politikave të Bankës. Këto ngjarje dhe procese kanë qenë të dhimbshme dhe të vështira për të gjithë. Duke parë nga e ardhmja, Grupi i Menaxherëve do të mbështetet në mësimet e nxjerra, për ta realizuar asistencën zhvillimore me standardet e larta, që presin dhe meritojnë klientët dhe partnerët tanë.

Aneksi 1

Plani i Zhvillimit të Bregdetit të Jugut

1. Një tregues kyç për arritjen e Objektivit Zhvillimor të Projektit është përfundimi dhe aprovimi i Planit të Zhvillimit të Bregdetit të Jugut (PZHBJ) nga Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit dhe nënshkrimi, më pas, nga Kryeministri. PZHBJ, që duhet plotësuar edhe me planet rregulluese të njëjësive vendore që marrin pjesë në proces, ka për synim nxitjen e administrimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke minimizuar, në të njëjtën kohë, efektet negative mjedisore të zhvillimit dhe infrastrukturës vendore, në bazë të pikave si vijon:

- Parimet e planifikimit mjedisor dhe zhvillimit të qëndrueshëm duhet të jenë medoemos tërësisht të integruar në vendimmarrjen zhvillimore, përfshirë edhe vlerat e brendshme natyrore dhe kulturore që shoqërojnë ekosistemet bregdetare;
- Investimet e infrastrukturës lipset të plotësojnë nevojat ekzistuese dhe të parashikuara për banorët dhe turistët. Infrastruktura duhet medoemos të projektohet në mënyrë të atillë që të minimizojë efektet mjedisore; dhe
- Turizmi planifikohet si sektori udhëheqës dhe katalizatori parësor i rritjes ekonomike, në ekonominë rajonale, çka kërkon: (a) një klimë transparente të investimeve; (b) procedura të thjeshta dhe të drejtpërdrejta për dhënien e lejeve; dhe (c) një mjedis ligjor dhe rregullator të qartë.

2. PZHBJ është miratuar, së pari, nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Rrethit Vlorë, më 1 korrik 2008, dhe nga Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit, më 18 korrik 2008.

3. Përpilimi i PZHBJ-së ka filluar në vitin 2005. Termat fillestare të referencës kërkonin vlerësimin e kapacitetit të tokës dhe infrastrukturës ekzistuese në zonën që do të mbulohej nga PZHBJ, për të mbështetur qëllimet e ndryshme të përdorimit të tokës, parashikimet e rritjes për secilën kategori të përdorimit të tokës gjatë një periudhe 10-vjeçare, analizë të efekteve mbi burimet natyrore dhe infrastrukturë, identifikimin e pikave më të përshtatshme për llojet e ndryshme të përdorimit të tokës dhe identifikimin e zonave ku duhen ndaluar apo penguar përdorime të caktuara të tokës. Në tetor 2006, Qeverisë iu dha versioni i parë paraprak i PZHBJ-së. Edhe pse studimi jepte shumë informacion mbi bregdetin jugor dhe pasqyronte pjesërisht pikëpamjet e palëve vendore të interesuara, relacioni nuk ishte në nivelin e kërkuar. Qeveria filloi procesin e zgjidhjes së kontratës dhe, në bazë të termave të reja të referencës, u mor një grup i dytë i konsulentëve në muajin gusht 2007 për të rifilluar hartimin e PZHBJ-së.

4. Përgatitja e PZHBJ-së përfundoi në muajin qershor 2008. PZHBJ mbështetet në Kodin Etik për Zonat Bregdetare të Bashkimit Evropian (BE). Kodi i BE-së përfaqëson parimet strategjike të “Strategjisë për shumëllojshmërinë biologjike dhe tokësore pan-evropiane”, që përkufizon elementet kyçe në lidhje me zhvillimin dhe administrimin e zonave bregdetare. Kodi i BE-së mbështetet në parimet e mëposhtme:

- Bregdetet e pazhvilluara janë një burim natyror jo i përtëritshëm dhe ruajtja e këtij burimi është i mundur përmes zbatimit të koncepteve të zhvillimit të qëndrueshëm;
- Zhvillimi i zonave bregdetare nuk bëhet vetëm për përdoruesit rekreativ, pronarët e tokës dhe autoritetet vendore; duhen marrë në konsideratë edhe interesat e gjerë kombëtarë dhe rajonale; dhe
- Janë të nevojshme norma ligjore të qarta të zbatueshme, që përcaktojnë të drejtat, dertimet dhe kufizimet mbi përdorimin e burimeve bregdetare, për të harmonizuar aspiratat e të gjitha palëve të interesuara për zonën bregdetare.

5. Në Kodin Etik të BE-së, vëmendje e veçantë u kushtohet sektorëve socialë dhe ekonomikë. Udhëzimet e përgjithshme mbulojnë çështjet e menaxhimit të integruar të zonave bregdetare, vlerësimit të efektit mjedisor, përdorimit të instrumenteve dhe nismave financiare dhe mbështetjes për përfshirjen e bashkësive në marrjen e vendimeve. Në mënyrë specifike, Kodi Etik i BE-së ofron udhëzime praktike për ruajtjen dhe zhvillimin e zonave bregdetare, ku përfshihet: (a) ruajtja e natyrës dhe biodiversitetit; (b) administrimi i pyjeve; (c) bujqësia; (d) industria; (e) mbrojtja e bregdetit; (f) turizmi dhe argëtimi; (g) mbrojtja ushtarake; (h) transporti; (h) energjia; (i) urbanizimi; (j) peshkimi dhe akuakultura; dhe (k) administrimi i burimeve ujore.

6. Ka pasur pjesëmarrje të gjerë të autoriteteve në nivel qendror dhe nivel bashkie, banorëve në zonë, sektorit privat dhe shoqërisë civile gjatë përgatitjes së PZHBJ-së. Trajnimi dhe dialogu me pjesëmarrje është zhvilluar për dy javë në bregdetin jugor në tetor 2007 me një numër të gjerë të palëve të interesuara nga pushteti qendror, rajonal dhe vendor, përfshirë edhe përfaqësues nga shoqatat dhe OJQ-të. Veprimtari të afrimit me publikun për projekt-PZHBJ-në janë zhvilluar në muajin dhjetor 2007 në Tiranë dhe bashkitë bregdetare të Himarës, Lukovës dhe Sarandës. Pas veprimtarive të afrimit me publikun, PZHBJ ishte i hapur për komente për dy muaj. Në muajin shkurt 2008, janë mbajtur konsultime publike si në Tiranë ashtu edhe në bregdetin e jugut.

7. PZHBJ do të orientojë veprimtaritë për të ruajtur mjedisin dhe trashëgiminë kulturore të bregdetit. Mirëpo, ai nuk është një plan në nivel vendor, i përshtatur sipas rrethanave konkrete të secilës bashki apo komunë, dhe ai nuk përmban hollësi të mjaftueshme të rregullimit të territorit që të mund të përdoren nga një bashki apo komunë në zbatimin e një sistemi të përmirësuar për dhënien dhe rregullimin e lejeve të ndërtimit.

8. Pas miratimit të PZHBJ-së nga Qeveria, pritet të fillojë planifikimi i përdorimit të tokës në nivel vendor, në fillim të vitit 2009. Planet vendore rregulluese në gjashtë bashkitë dhe komunat e zonës së Projektit do të mbështeten në kriteret e miratuara dhe rregulloret bregdetare të PZHBJ-së dhe do të nxjerrin si rezultat një plan rregullues për secilin komunitet. Procesi i planifikimit do të mbështetet në planifikimin me pjesëmarrje si ai i procesit rajonal të PZHBJ-së dhe pritet të zbatojë angazhimet që ka Shqipëria në kuadër të Konventës së Aarhusit. Përgatitja dhe miratimi i këtyre planeve është një parakusht thelbësor për vendosjen e një sistemi racional, transparent, të drejtë dhe të

bazuar në kritere për të dhënë lejet për ndërtimet e reja, i pranuar nga të gjitha palët e interesuara dhe që pasqyron mendimet e tyre.

9. Procesi i konsultimeve për PZHBJ-në është cituar nga Sekretariati i Konventës së Aarhusit si një praktikë e mirë që duhet ndjekur edhe nga agjencitë e tjera qeveritare në lidhje me zbatimin e kërkesave të Konventës së UNECE-së “Për të drejtën e shikimit të informacionit, pjesëmarrjen publike në marrjen e vendimeve të drejtën për drejtësi në çështjet mjedisore”, që është nënshkruar më 25 qershor 1998, në Aarhus të Danimarkës. Konventa e Aarhusit i jep publikut të drejta në lidhje me informimin, pjesëmarrjen dhe drejtësinë në proceset qeveritare të vendimmarrëse për çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkufitar. Ajo përqendrohet në marrëdhëniet midis publikut dhe autoriteteve qeveritare.

Aneksi 2

Konstatime, komente dhe veprime

Nr	Çështja/konstatimet	Nr. i paragrafit	Komenti/veprimi
PO/PB 4.12 “SHPËRNGULJA E DETYRUAR”			
1.	<p>Aplikimi i PO/PB 4.12 në rastin e vënies në zbatim të Planit të Zhvillimit të Bregdetit të Jugut (PZHBJ)—planet rregulluese</p> <p>Paneli konstaton se objektivat dhe përmbajtja e Projektit, përfshirë edhe PZHBJ-në, shkojnë përtej rregullimit të burimeve natyrore dhe, për rrjedhojë, aplikohet Politika.</p>	151-154	<p>KOMENT: Politika e Bankës Botërore “Për shpërnguljen e detyruar” (PO/PB 4.12) është një politikë kyçe për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Objektivi i kësaj politike është shmangia ose minimizimi i shpërnguljes së detyruar në kuadër të projekteve të financuar nga Banka Botërore dhe, kur kjo nuk është e realizueshme, asistimi i personave të shpërngulur për të përmirësuar ose, të paktën, për t'i rivendosur mjetet dhe standardet e tyre të jetesës në terma reale në raport me nivelet përpara shpërnguljes apo me nivelet që mbizotëronin përpara se të fillonte vënia në zbatim e projektit, cilado qofshin më të lartët.</p> <p>PO/PB 4.12 thotë: <i>“Kjo politikë mbulon efektet ekonomike dhe sociale të drejtpërdrejta, të cilat vijnë si rezultat i projekteve të investimeve të asistuara nga Banka dhe shkaktohen nga... (a) marrja me detyrim e tokës... dhe... (b) kufizimi me detyrim i hyrjes në parqet e përcaktuara me ligj dhe zonat e mbrojtura që sjell si rezultat efekte negative të padëshirueshme të mjetet e jetesës së personave të shpërngulur”.</i> Kjo politikë nuk i mbulon efektet e tërthorta.</p> <p>PO/PB 4.12 parashtron veprimtaritë për të cilat nuk aplikohet. Këto përjashtime mbulohen nga një poshtëshënim, i cili rithekson edhe rëndësinë e vlerësimit të mirë social. Përjashtimet janë parashikuar si më poshtë:</p> <p><i>“Kjo politikë nuk aplikohet për rregullimet e burimeve natyrore në nivel qendror ose rajonal për të nxitur qëndrueshmërinë e tyre, si për shembull administrimi i baseneve ujore, administrimi i ujërave nëntokësore, administrimi i peshkimit, etj. Kjo politikë nuk aplikohet as për mosmarrëveshjet midis palëve private në projektet e dhënies së titujve të tokës, edhe pse është e udhës që huamarrësi të ndërmarrë një vlerësim social dhe të zbatojë masa për minimizimin dhe zbutjen e efekteve sociale negative të padëshirueshme, sidomos të atyre efekteve që prekin grupet e varfra dhe të prekshme të popullsisë.”</i></p> <p>Megjithëse poshtëshënimi 8 i PO/PB 4.12 nuk e përmend shprehimisht rregullimin e territorit, ai është një formë e rregullimit të burimeve natyrore që kishin për synim hartuesit të mbulohej nga politika në fjalë. Përjashtimi i rregullimeve të burimeve natyrore ka pasur për synim të sigurojë që qeveritë të mos jenë gjithmonë të detyruara të japin kompensim dhe asistencë për shpërnguljen personave të prekur nga veprimtari të tilla planifikimi dhe rregullimit, pavarësisht ligjshmërisë së përdorimit të tokës nga ana e tyre. Këto veprimtari ndryshojnë nga investimet konkrete në infrastrukturë, siç janë digat e mëdha, sepse nuk mund të piketohen konkretisht në një vendndodhje të caktuar dhe hartuesit e projektit nuk e dinë se ku, kur dhe si mund të preken njerëzit. Në vend të kësaj, proceset e administrimit të burimeve natyrore dhe rregullimi i territorit përqendrohen në planifikimin në nivelet e larta dhe, në përgjithësi, nuk kërkojnë marrje të tokës për veprimtaritë e projektit. Shembujt përkatës përfshijnë rastin kur ndihmohen qeveritë për të t'u vënë fre ndërtimeve të përhapura në zonat që janë të prekshme nga</p>

Nr	Çështja/konstatimet	Nr. i paragrafit	Komenti/veprimi
			<p>përmbytjet apo kur ndihmohen për t'u dhënë fund ndërtimeve të paligjshme në zona delikate.</p> <p>Nëse PO/PB 4.12 do të aplikohet për të gjithë personat e prekur brenda zonave të tilla që mbulon rregullimi, hartuesit e politikës e dinë se qeveritë nuk do t'ia lejonin vetes të ndërmerrnin këto nisma të rëndësishme. Paketat për shpërnguljen sipas PO/PB 4.12 do të kërkonin, ndër të tjera, që qeveria të paguante kompensimin e vlerës për shpërnguljen dhe të ofronte asistencë për mjetet e jetesës për të gjithë personat e prekur, pavarësisht faktit nëse ndërtesa është ndërtuar apo jo në mënyrë të ligjshme apo nëse zotërojnë apo jo titull të ligjshëm. Kështu, për shembull, një qeverie mund t'i kërkohej të paguante vlerën e ndërtimeve të ngritura në mënyrë të paligjshme në zona ku pasuritë e paluajtshme kanë vlerë të lartë. Aplikimi i politikës në veprimtaritë e rregullimit të territorit do të kërkonte që të plotësoheshin kushtet për kompensim për shkak të një zvogëlimi të mundshëm të vlerave të tokës në zona të caktuara si rezultat i ndryshimeve që sjell plani rregullues. Në raste të tilla, do të kompensohej përdorimi i ligjshëm i tokës në përputhje me ligjet vendore dhe procesin e rregullt që rregullojnë shpronësimin e pasurive.</p> <p>Grupi i Menaxherëve ndjen keqardhje që logjika mbi të cilën mbështetet moszbatimi i PO/PB 4.12 nuk është dokumentuar mjaftueshëm në DVP. Po kështu, Grupi i Menaxherëve vëren se, në dallim nga praktika e mirë, gjatë përgatitjes së Projektit nuk janë kryer vlerësime sociale, institucionale apo ligjore.</p> <p>VEPRIMI:</p> <p>1. Grupi i Menaxherëve do të ndërmarrë një shqyrtim të aplikimit të politikave mbrojtëse në projektet që mbështesin planifikimin e përdorimit të tokës (rregullimit të territorit). Në bazë të këtij shqyrtimi, Grupi i Menaxherëve do të përgatisë dhe shpërndajë: (a) një qartësim të politikës në lidhje me mënyrën se si aplikohet poshtëshënimi 8 i PO/PB 4.12 në rastin e projekteve të rregullimit të territorit; dhe (b) një dokument udhëzues sa i takon aplikimit të politikave mbrojtëse në projektet që mbështesin rregullimin të territorit. Dokumenti Udhëzues do të mbulojë si aplikimin e PO/PB 4.12 ashtu edhe përdorimin e masave të tjera për të trajtuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Qartësimi i politikës dhe Dokumenti Udhëzues do të dalin më 30 qershor 2009.</p> <p>2. Për punonjësit në të gjitha rajonet do të ofrohet trajnim i synuar, në mbështetje të zbatimit të këtij udhëzuesi.</p>
2.	<p>Analiza e vendimit të Grupit të Menaxherëve për të mos aplikuar PO/PB 4.12 në rastin e prishjes objekteve në zbatim e sipër në zonën e Projektit</p> <p>Paneli habitet nga vendimi i Grupit të Menaxherëve se “nuk ka lidhje” midis programit të Qeverisë së Shqipërisë për prishjen e objekteve dhe objektivave të Projektit, sikurse parashikohet në paragrafin 4 të PO/PB 4.12. Programet e Qeverisë për</p>	114-141	<p>KOMENT: Në kohën kur i është paraqitur Projekti Bordit, Grupi i Menaxherëve gjykonte se PO/PB 4.12 nuk aplikohet për përgatitjen e PZHBJ-së dhe vlerësonte se programi i Qeverisë, në zbatim e sipër, për prishjen e objekteve ishte jashtë objektivit të Projektit. Grupi i Menaxherëve ishte e mendimit se PZHBJ ishte një veprimtari që administronte burimet natyrore, e përjashtuar nga politika, për shkak të poshtëshënimit 8 të lidhur me paragrafin 3 të PO/PB 4.12, që i përjashton “rregullimet e burimeve natyrore në nivel kombëtar apo rajonal që nxisin qëndrueshmërinë e tyre”.</p> <p>Grupi i Menaxherëve pranon se veprimet që kanë ndodhur ilustrojnë paqartësinë e faktit nëse duhej aplikuar</p>

Nr	Çështja/konstatimet	Nr. i paragrafit	Komenti/veprimi
	<p>prishjen e objekteve synojnë të zbatojnë me forcë kërkesat e rregullimit të territorit dhe pikërisht qëllimi i Projektit është nxitja e menaxhimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të zonës bregdetare, përfshirë edhe përmes masave të rregullimit të territorit dhe zbatimit me forcë të tyre. Paneli konstaton se lloji i largimit të zaptimeve që synon të realizojë Qeveria e Shqipërisë në zonën e mbuluar nga Projekti i asistuar nga Banka, duket qartë se bie brenda tri kategorive të përcaktuara në paragrafin 4 të PO/PB 4.12 “Shpërngulja e detyruar”. Domethënë: (a) Programi i Qeverisë për prishjen e objekteve synon arritjen e objektivave të cilët deklarohen se janë të njëjtë me objektivat që kërkon të arrijë vetë Projekti – zhvillimi i qëndrueshëm dhe përdorimi i duhur i zonës bregdetare; (b) si të tilla, këto aktivitete janë me domosdo pjesë e masave të nevojshme për arritjen e këtyre objektivave; dhe (c) këto aktivitete planifikohen dhe zbatohen në të njëjtën kohë me Projektin, brenda kuptimit të paragrafit 4 të PO/PB 4.12. Paneli vëren se vendimi i Grupit të Menaxherëve për të mos e aplikuar Politikën, sikurse thuhet në DVP, bie ndesh me dispozitat e Politikës dhe lidhet me këndvështrimin se prishja e shtëpive nuk përbën “<i>marrje të tokës</i>”. Kjo qasje e metë duket se është një tjetër arsye që qëndron pas vendimit të Grupit të Menaxherëve për të mos e aplikuar PO/PB 4.12 për Projektin.</p> <p>Paneli vëren gjithashtu se vendimi i Grupit të Menaxherëve për të mos e aplikuar Politikën, sikurse thuhet në DVP, bie ndesh me dispozitat e Politikës dhe lidhet me këndvështrimin se prishja e shtëpive nuk përbën “<i>marrje të tokës</i>”. Kjo qasje e metë duket se është një tjetër arsye që qëndron pas vendimit të Grupit të Menaxherëve për të mos e aplikuar PO/PB 4.12 për Projektin.</p>		<p>apo jo PO/PB 4.12, duke pasur parasysh veprimtarinë në zbatim e sipër të Qeverisë për prishjen e objekteve në zonën e Projektit.</p> <p>Pavarësisht faktit nëse duhej të ishte aplikuar apo jo PO/PB 412, ky nuk është një justifikim për mosaplikimin e praktikës së mirë për ato lloje të efekteve negative të padëshirueshme sociale dhe ekonomike të cilave duhet t’u kishte paraprirë Grupi i Menaxherëve. Kjo do të kishte ndihmuar në shmangien e efekteve negative të padëshirueshme për Kërkuesit dhe për reputacionin e Bankës Botërore. Skema e Projektit nuk përfshiu një vlerësim të plotë të aspekteve shoqërore, juridike dhe institucionale apo mekanizma e procesit të rregullt të cilët do të kishin ndihmuar në mbrojtjen e Kërkuesve.</p> <p>Në dritën e kërcënimit të ditur të prishjes së mundshme të objekteve, Grupi i Menaxherëve duhet të kishte ngulur këmbë për vendosjen e një moratoriumi mbi veprimtarinë e prishjes së objekteve në zonën e Projektit deri në çastin kur do të ishin përgatitur PZHBJ dhe planet vendore përkatëse dhe kur do të vihej në zbatim paketa e masave të mbrojtjes sociale.</p> <p>VEPRIMI:</p> <p>1. Banka do të financojë kostot e përzgjedhura për realizimin e një shqyrtimi rast pas rasti në sistemin gjyqësor shqiptar, të padive të Kërkuesve dhe pretendimeve të tyre se janë dëmtuar si rezultat i prishjes së objekteve në prill 2007 dhe se duhet të dëmshpërblehen si rezultat i prishjes së objekteve. Këto kosto do të përfshijnë shërbimet ligjore të kërkuara nga Kërkuesit, përfshirë këtu, nëse është e nevojshme, edhe për apelimet e bazuara pas gjykimit. Ato do të përfshijnë edhe pagesën e një vëzhguesi të pavarur, të pranueshëm për Bankën, i cili do t’i raportojë Bankës në lidhje me transparencën, besueshmërinë, pavarësinë dhe realizimin në kohë të procesit të gjykimit. Për t’i mundësuar këto veprime, Banka do të konfirmojë garancinë e Qeverisë se do të bëhen të gjitha përpjekjet e mundshme për përfundimin e përsheptuar të këtij shqyrtimi gjyqësor, duke njohur, në të njëjtën kohë, dhe duke u angazhuar për të respektuar tërësisht pavarësinë e gjyqësorit. Banka do të konfirmojë edhe që Qeveria do të ofrojë të gjithë dokumentacionin që ka në dispozicion, të nevojshëm për shqyrtimin gjyqësor, dhe që Qeveria nuk do të ketë kundërshtim për një propozim të arsyeshëm për bashkimin në një çështje të padive të Kërkuesve. Më tej, Banka do të konfirmojë edhe që Qeveria do të respektojë dhe do të përmbushë menjëherë të gjithë vendimet e gjykatës, të dala nga procesi i shqyrtimit gjyqësor, përfshirë edhe çdo vendim për t’i dëmshpërblen paditësit. Nëse procesi gjykohej si i pakënaqshëm nga vëzhguesi i Bankës, Grupi i Menaxherëve ruan të drejtën për të (i) pezulluar lëvrimet e fondeve, në kuadër të Projektit të ristrukturuar; dhe (ii) të ofrojë asistencë të drejtpërdrejtë për Kërkuesit, edhe pse, juridikisht, Banka nuk është e detyruar ta bëjë një gjë të tillë.</p> <p>2. Grupi i Menaxherëve do të mbikëqyrë kryerjen e Vlerësimit Social dhe të Prekshmërisë, në përputhje me termat e referencës për të cilat është rënë dakord me Bankën, si edhe zbatimin me fuqi prapavepruese të paketës së asistencës që do të dalë prej tij për popullsinë e varfër dhe/ose në pozita të cenueshme, për familjet e prekura nga prishja e objekteve në</p>

Nr	Çështja/konstatimet	Nr. i paragrafit	Komenti/veprimi
			<p>prill 2007.</p> <p>3. Grupi i Menaxherëve do t'i raportojë Bordit, pas tre muajsh, në lidhje me shqyrtimin gjyqësor rast pas rasti, si edhe në lidhje me Vlerësimin Social dhe të Prekshmërisë.</p> <p>4. Nëse merret një vendim për të ristrukturuar Projektin, Grupi i Menaxherëve propozon ruajtjen e mbështetjes për këto veprimtari: (i) pastrimi i mbetjeve të rrezikshme në Porto-Romano; (ii) ndërtimi i një vend- groposjeje për mbeturinat (landfill) dhe përgatitja e një sistemi të administrimit të mbetjeve të ngurta; (iii) ndërtimi i një terminali të udhëtarëve në Portin e Sarandës; (iv) investime në shkallë të vogël në ujësjellës-kanalizime në qytetin e Sarandës dhe në fshatrat e vegjël të Bregdetit të Jugit; (v) investime me bazë komunitetin në fshatrat bregdetare; dhe (vi) administrimi i zonave të mbrojtura të Parkut Kombëtar të Butrintit. Do të anuloheshin të gjitha veprimtaritë e rregullimit të territorit dhe fondet e lidhura me to do t'u rishpërndahen veprimtarive të tjera. Ristrukturimi i propozuar do t'i paraqitej Bordit për miratim. Gjatë ristrukturimit të Projektit, pezullimi i lëvrimit të fondeve do të hiqej për të gjitha veprimtaritë me përjashtim të atyre të rregullimit të territorit, për të siguruar vijimin e zbatimit të investimeve të rëndësishme në infrastrukturë. Grupi i Menaxherëve do t'i raportojë Bordit, pas tre muajve, në lidhje me Projektin.</p>
3.	<p>Aplikimi i PO/PB 4.12 për investimet në infrastrukturë pas miratimit të PZHBJ-së</p> <p>Paneli nuk e ka shqyrtuar mjaftueshmërinë e Kuadrit të Politikave të Shpërnguljes të miratuar nga Qeveria e Shqipërisë, që Grupi i Menaxherëve thotë se do të aplikohet për investimet konkrete të mbështetura në kuadër të PZHBJ-së, megjithatë Paneli konstaton se dispozitat e PO/PB 4.12 lipset të aplikohen për investimet, të cilat ndjekin kuadrin planifikues të PZHBJ-së.</p> <p>Megjithatë, për Panelin nuk është e qartë se si do ta monitorojë dhe mbikëqyrë Banka zbatimin e ESSF-së në përputhje me politikat përkatëse të Bankës, në rastet e investimeve të infrastrukturës që nuk financohen drejtpërdrejt nga SHNZH.</p>	161-162	<p>KOMENT: Grupi i Menaxherëve pajtohet me Panelin se dispozitat e PO/PB 4.12 lipset të aplikohen në rastin e investimeve të financuara nga Projekti, të cilat ndjekin kuadrin planifikues të PZHBJ-së. Si të tilla, ato mbulohen nga ESSF. Grupi i Menaxherëve e pranon gabimin në ESSF në lidhje me investimet e infrastrukturës të financuara jashtë Projektit dhe dëshiron të sqarojë se në këto raste nuk do të aplikohet PO/PB 4.12.</p> <p>VEPRIMI:</p> <p>1. Shih Pikën 2 për shqyrtimin gjyqësor, Vlerësimin Social dhe të Prekshmërisë dhe ristrukturimin e Projektit.</p> <p>2. Zyra e Bankës Botërore në Tiranë, Shqipëri, do të kryejë trajnim periodik për stafin e projekteve dhe qeveritarët, në lidhje me aplikimin e politikave të masave mbrojtëse të Bankës në rastin e projekteve të portofolit në Shqipëri.</p>
4.	<p>Trajtimi jo i njëjtë për personat e prekur</p> <p>Paneli konstaton se një qasje e tillë, që është jo e njëjtë për të gjithë, në lidhje me aplikimin e PO 4.12 mund të çojë në trajtim të ndryshëm të personave të prekur, të ndodhur në situata të ngjashme në faza të ndryshme të Projektit. Paneli konstaton se rezultate të tilla duhet të ishin parashikuar gjatë</p>	163-166	<p>KOMENT: Grupi i Menaxherëve pajtohet me Panelin, se PO/PB 4.12 parashtron një qasje me trajtim jo të njëjtë, në lidhje me personat e prekur.</p> <p>Në dritën e kërcënimit të ditur të prishjes së mundshme të objekteve, Grupi i Menaxherëve duhet të kishte ngulur këmbë për vendosjen e një moratoriumi mbi veprimtaritë e prishjes së objekteve në zonën e Projektit deri në çastin kur do të ishin përgatitur PZHBJ dhe planet vendore përkatëse dhe kur do të vihej në zbatim paketa e masave të mbrojtjes sociale. Projekti nuk duhej t'i ishte paraqitur për miratim Bordit, në</p>

Nr	Çështja/konstatimet	Nr. i paragrafit	Komenti/veprimi
	strukturimit të Projektit dhe se lënia pas dore e mundësisë së ndodhjes së tyre përbën një dështim të interpretimit të Politikës dhe një moszbatim thelbësor të aplikimit të nevojshëm të Politikës së Bankës për shpërnguljen e detyruar.		mungesë të një moratoriumi për prishjen e ndërtimeve ekzistuese. VEPRIMI: 1. Shih Pikën 1 për sqarimin e PO/PB 4.12 në lidhje me rregullimin e territorit (planifikimin e përdorimit të tokës). 2. Shih Pikën 3 për trajnimin në lidhje me aplikimin e polikave mbrojtëse të Bankës.
PO/PB 10.00 “HUADHËNIA PËR INVESTIME: NGA IDENTIFIKIMI DERI NË PARAQITJEN PËR BORDIN”			
5.	<p>Pretendimi për “marrëveshjen” për të pezulluar prishjen e objekteve</p> <p>Në mungesë të aplikimit të Politikës së Bankës për shpërnguljen e detyruar, kjo “marrëveshje” e pretenduar me Qeverinë e Shqipërisë për pezulluar prishjen e objekteve në zonën e Projektit, të përmendur në DVP, të jepte përshtypjen se ekzistonte një masë mbrojtëse për të mbrojtur personat mundësisht të prekur dhe Bankën nga rreziku kritik i Projektit që do të vinte nga prishja e objekteve. Mirëpo, gjatë investigimit, Paneli mësoi se Qeveria nuk kishte marrë asnjë angazhim të tillë dhe nuk kishte rënë dakord me atë që thoshte DVP. Doli se fjalja me rëndësi jetike, e cituar më lart, ishte e pabazë dhe e pasaktë. Gjatë Mbledhjes së Bordit, Grupi i Menaxherëve nuk e informoi Bordin në lidhje me këtë fakt, megjithëse Drejtorët Ekzekutivë vunë në dukje se e mirëprisnin ekzistencën e kësaj marrëveshjeje.</p> <p>Paneli konstaton se pa marrëveshjen e pretenduar me Qeverinë e Shqipërisë, për ta pezulluar prishjen e objekteve në zonën e Projektit, pa një marrëveshje në lidhje me datën ndarëse në kohë dhe, mbi të gjitha, pa aplikuar Politikën e Bankës për shpërnguljen e detyruar për prishjet në kryerje e sipër, Grupi i Menaxherëve nuk arriti t'i mbrojë personat mundësisht të prekur nga aktivitetet e lidhura me Projektin. Kjo përbën moszbatim të PO/PB 4.12 për shpërnguljen e detyruar. Krahas kësaj, Grupi i Menaxherëve nuk e mbrojti Bankën nga një rrezik i ndjeshëm reputacioni, të pranuar edhe në DVP.</p>	142-150	<p>KOMENT: Janë bërë një sërë gabimesh gjatë gjithë ciklit të Projektit. Grupi i Menaxherëve është një mendje me Panelin se deklarimi në DVP në lidhje me pezullimin e prishjes së objekteve nuk është i saktë dhe se pa një moratorium të tillë nuk janë zbutur si duhet rreziqet sociale me rëndësi kritike.</p> <p>VEPRIMI:</p> <p>1. Shih Pikën 2 për shqyrtimin gjyqësor, Vlerësimin Social dhe të Prekshmërisë dhe ristrukturimin e Projektit.</p> <p>2. Duke pasur parasysh rëndësinë e gabimeve të identifikuar për Projektin, Presidenti i Bankës Botërore i ka kërkuar Këshilltarit të Përgjithshëm në detyrë të kryejë një shqyrtim të rrethanave që lidhen me nxjerrjen e Ndrejjes së Gabimeve të muajit shtator 2008. Në bazë të këtij shqyrtimi, Presidenti i ka kërkuar Departamentit për Integritet Institucional të Bankës Botërore të drejtojë një Analizë të Llogaridhënies, për keqparaqitjen e pretenduar të informacionit përpara Panelit të Inspektimit dhe për ngjarjet që lidhen me përgatitjen e Projektit, paraqitjen përpara Bordit dhe mbikëqyrjen e Projektit.</p> <p>3. Staf i drejtues rajonal ka realizuar një shqyrtim të plotë të portofolit me 302 projekte në Regjionin e EAQ-së, për t'u dhënë zgjidhje shqetësimeve të ngritura në lidhje me cilësinë dhe saktësinë e DVP-ve, për t'u kujdesur që këto dokumente: (a) të pasqyrojnë si duhet marrëveshjet e arritura me Huamarrësin; (b) të japin përshtypjen e saktë për realitetin dhe perspektivën; dhe/ose (c) të përfshijnë informacionet me rëndësi kritike. Grupi i Menaxherëve angazhohet t'i marrë të gjitha masat e duhura, brenda autoritetit të saj, për t'u dhënë zgjidhje këtyre problemeve brenda datës 30 qershor 2009.</p> <p>4. Staf i lartë drejtues i Bankës Botërore e ka zgjeruar këtë proces shqyrtimi, për të përfshirë përafërsisht 1.550 projektet e portofolit të saj, si edhe kuadrin organizativ për kontrollin e cilësisë në të gjitha Regjionet. Rezultatet e plota të këtij Shqyrtimi dhe veprimet e propozuara për fuqizimin e kontrollit të cilësisë dhe trajnimin operativ të drejtuesve të ekipeve të projekteve do t'i raportohen Bordit në kohën kur do të diskutohet kjo Përgjigje e Grupit të Menaxherëve.</p>
6.	<p>Shqyrtimi nga Paneli, i tekstit të zbardhur të mbledhjes së Bordit</p> <p>Gjatë takimit me ekipin e Projektit dhe Ekipin Administrues të Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë, ekipi i</p>	254-270	<p>KOMENT: Grupi i Menaxherëve pajtohet me Panelin se DVP-ja, që i është paraqitur Bordit më 21 qershor 2005, e keqparaqiste ekzistencën e një marrëveshjeje me Qeverinë për një moratorium mbi prishjen e detyrim të objekteve. Keqparaqitja në fjalë kishte të bënte me një aspekt jetik në skemën e Projektit. Grupi i Menaxherëve nuk e ndreqi</p>

Nr	Çështja/konstatimet	Nr. i paragrafit	Komenti/veprimi
	<p>Panelit kërkoi informacion për marrëveshjen me Qeverinë për të mos vijuar prishjen e ndërtimeve në zonën e Projektit, siç thuhet në DVP. Ekipi i Projektit ia të kuptojë se kishte një gabim në DVP dhe se nuk ekziston një marrëveshje e tillë (sic) me Qeverinë.</p> <p>Ekipi i Projektit i ia të kuptojë ekipit të Panelit edhe se gjatë diskutimit në Bord, Grupi i Menaxherëve ua kishte sqaruar anëtarëve të Bordit se ky deklaram në DVP ishte një “gabim”. Paneli konstatoi se paragrafi që pretendohet se ishte përfshirë në deklaratën e lartpërmendur të Bordit dhe që ia kishte dhënë Panelit Grupi i Menaxherëve nuk është lexuar përpara Bordit. Paneli konstatoi se kjo deklaratë do t'i kishte dhënë Bordit një informacion faktik me rëndësi të madhe në lidhje me statusin e një mase për zbutjen e një rreziku me rëndësi kritike në DVP, masë, e cila u mirëprit nga anëtarët e Bordit kur e miratuan Projektin. Kjo bie ndesh me DMP 2.20 dhe Aneksin D të PB 10.00 “Mbi huadhënien për investime: nga Identifikimi deri në Paraqitjen për Bordin.</p> <p>Deri në këtë moment, Paneli nuk e di pse dhe kur vendosi Grupi i Menaxherëve të mos bëjë të ditur se ajo që thuhet në DVP ishte gabim dhe se si është zhvilluar kjo çështje me kalimin e kohës. Paneli është shumë i shqetësuar nga keqparaqitja e informacionit faktik të rëndësishëm nga Grupi i Menaxherëve përpara Panelit. Kjo bie ndesh me procesin e përcaktuar në Rezolutën e Bordit që krijon Panelin dhe me dispozitat e PB 17.55.</p>		<p>përmendjen e gabuar të moratoriumit në DVP gjatë mbledhjes së Bordit, edhe atëherë kur anëtarët e Bordit e mirëpritën marrëveshjen e pretenduar, në deklaratat me shkrim të tyre. Grupi i Menaxherëve nuk shfrytëzoi as një mundësi tjetër për ta ndrequr këtë gabim kur aprovuan “Përmbledhjen e Deklaratës së Bordit”, edhe pse këtë deklaratë e kaluan persona të cilët e dinin se nuk ekzistonte asnjë moratorium. Sa u takon pretendimeve se i është keqparaqitur informacioni Panelit, Presidenti i ka kërkuar Departamentit të Bankës për Integritet Institucional të kryejë një analizë llogaridhënieje për keqparaqitjen e pretenduar dhe për ngjarjet që lidhen me përgatitjen e Projektit, paraqitjen përpara Bordit dhe mbikëqyrjen e Projektit.</p> <p>VEPRIMI:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shih Pikën 5 për shqyrtimin e llogaridhënies. 2. Shih Pikën 5 për shqyrtimin e plotë të portofolit të Rajonit të Evropës dhe Azisë Qendrore. 3. Shih Pikën 5 për shqyrtimin mbarë-institucional të portofolit të Bankës dhe për kuadrin e masave të kontrollit të cilësisë.
PO/PB 13.05 “MBIKËQYRJA E PROJEKTEVE”			
7.	<p>Mungesa e largpamësisë dhe masave përshtatëse. Paneli është i shqetësuar në lidhje me mungesën e largpamësisë nga ana e Grupit të Menaxherëve në lidhje me pasojat e vonesës së ndjeshme në përfundimin e PZHBJ-së. Paneli është po aq i shqetësuar se skema e Projektit nuk u rishikua dhe nuk iu përshtat realiteteve të reja pas vonesave të ndjeshme në përmbylljen e fazës planifikuese. Kjo nuk përputhet me dispozitat e PO/PB 13.05 “Për mbikëqyrjen”.</p>	160	<p>KOMENT: Grupi i Menaxherëve pajtohet me vlerësimin e Panelit se Projekti nuk iu përshtat rrethanave të ndryshuara pasi u vonua përgatitja e PZHBJ-së me më shumë se dy vjet.</p> <p>VEPRIMI:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shih Pikën 2 për shqyrtimin gjyqësor, Vlerësimin Social dhe të Prekshmërisë dhe ristrukturimin e Projektit.

Nr	Çështja/konstatimet	Nr. i paragrafit	Komenti/veprimi
8.	<p>Lidhjet midis prishjes së objekteve në Jalë dhe Projektit</p> <p>(a) Komunikimet e Projektit në lidhje me prishjen e objekteve në Jalë</p> <p>(b) Shtëpitë e prishura të identifikuara nga fotografitë ajrore të financuara në kuadër të Projektit</p> <p>(c) Asistenca për Policinë e Ndërtimit</p> <p>Investigimi i Panelit zbuloi një lidhje të rëndësishme dhe të drejtpërdrejtë midis Projektit dhe prishjes së objekteve në Jalë. Në të vërtetë, informacioni i regjistruar i Projektit tregon se ka pasur një marrëdhënie aktive midis Projektit dhe Policisë së Ndërtimit dhe nxjerr në pah faktin se fotografitë ajrore të financuara në kuadër të Projektit kanë shërbyer për të identifikuar ndërtesat që u prishën.</p> <p>Më 26 mars 2007, NJKP u ka dërguar një letër, me kokën zyrtare të letrës të Projektit të Financuar nga Banka, e nënshkruar nga Koordinatori i Projektit, thuajse të gjitha autoriteteve qeveritare përkatëse të nivelit të lartë, përfshirë edhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Ndërtimit, ku i njoftonte këto autoritete për ato që ai i karakterizonte si ndërtesa të paligjshme përgjatë bregut të Detit Jon. Bashkëlidhur kësaj letre, dërgoheshin dy kompakt disqe me foto ajrore të bregdetit. Fotot ajrore të bregdetit janë financuar nga Projekti. Është e rëndësishme të theksohet se NJKP e ka dërguar këtë shkresë me kokën zyrtare të letërkëmbimit të Projektit të financuar nga Banka dhe se letra është nënshkruar nga drejtuesi i NJKP-së, me cilësinë e Koordinatorit të Projektit, dhe se bashkëlidhur shkresës janë dërguar fotografitë ajrore të financuara nga Projekti. Në përgjigjen e saj, Policia e Ndërtimit thoshte se kishte kryer të gjitha procedurat e nevojshme dhe vendimet për prishjen e këtyre objekteve u ishin njoftuar palëve përkatëse.</p> <p>Të dhënat e regjistruara të Projektit tregojnë se Projekti ka dhënë mbështetje, si materiale ashtu edhe teknike, për Policinë e Ndërtimit për prishjen e objekteve, e cila ishte shkaku i paraqitjes së Kërkesës për Inspektim. Pika më e rëndësishme</p>	172-207	<p>KOMENT: Grupi i Menaxherëve i pranon konstatimet e Panelit në lidhje me veprimet e Njësisë Shqiptare të Koordinimit të Projektit dhe efektet që kanë pasur ato për Kërkesit. Grupi i Menaxherëve vëren se prishja e objekteve në Jalë nuk ka qenë autorizuar nga Banka Botërore. Megjithatë, Grupi i Menaxherëve është në dijeni se më datë 26 mars 2007, më pak se një muaj përpara prishjes së objekteve në bregdetin jugor, Njësia Shqiptare e Koordinimit të Projektit u ka dërguar një letër, me kokën zyrtare të letërkëmbimit të Projektit, qeveritarëve të nivelit të lartë, si edhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Ndërtimit. Në këtë letër, Njësia e Koordinimit të Projektit vëren se po vazhdojnë ndërtimet e paligjshme në bregdetin jugor të Shqipërisë dhe thotë se,</p> <p><i>“Duke pasur parasysh rëndësisë e zhvillimit të qëndrueshëm të kësaj zone dhe efektin që ka në zhvillim e përgjithshëm ekonomik dhe të turizmit në vend, sa i takon mjedisit, <u>ju lutem kujdesuni të merrni masat e nevojshme, sa më shpejt të jetë e mundur.</u>”</i> [Nënvizimi është shtuar.]</p> <p>Pas më pak se dy javësh, Policia e Ndërtimit iu është përgjigjur Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Njësisë së Koordinimit të Projektit, ku u bënte me dije se,</p> <p><i>“Drejtorja e Policisë së Ndërtimit ka kryer të gjitha procedurat ligjore të nevojshme që kanë të bëjnë me raste të tilla dhe vendimet për prishjen e këtyre objekteve u janë njoftuar palëve përkatëse, duke u dhënë atyre mundësinë e bërjes së ankesës dhe të paraqitjes së dokumenteve që kanë për këto ndërtime.”</i></p> <p>Prishja e objekteve në Jalë filloi pas një jave.</p> <p>Grupi i Menaxherëve e pranon se prishja e këtyre objekteve i ka prekur negativisht Kërkesit. Grupi i Menaxherëve pranon gjithashtu se veprimet që kanë ndodhur ilustrojnë paqartësinë e faktit nëse duhej aplikuar apo jo PO/PB 4.12, duke pasur parasysh veprimtaritë në zbatim e sipër të Qeverisë për prishjen e objekteve në zonën e Projektit. Grupi i Menaxherëve duhet të kishte ngulur këmbë për vendosjen e një moratoriumi mbi veprimtaritë e prishjes së objekteve në zonën e Projektit deri në çastin kur do të ishin përgatitur PZHBJ dhe planet vendore përkatëse dhe kur do të vihej në zbatim paketa e masave të mbrojtjes sociale.</p> <p>Grupi i Menaxherëve është dakord se ngjarjet në terren kanë krijuar një situatë, në të cilën palëve të prekura u duhet dhënë asistencë.</p> <p>Grupi i Menaxherëve pajtohet me Panelin e Inspektimit se ka pasur dështim në mbikëqyrjen e Projektit. Pasi mësoi për prishjen e objekteve, Grupi i Menaxherëve duhet të kishte vepruar menjëherë, për t'u takuar me personat e prekur dhe për të diskutuar me Qeverinë për mjetet e zbutjes së efekteve negative. Për më tepër, qysh prej fillimit të vënies në zbatim të Projektit, Grupi i Menaxherëve duhet ta kishte sqaruar rolin e Njësisë së Koordinimit të Projektit kundrejt programit në zbatim e sipër të Qeverisë për prishjen e objekteve, duke ditur rreziqet që u kanoseshin objektivave të Projektit për shkak të programit të prishjes së objekteve</p> <p>Grupi i Menaxherëve vëren se pajisjes për mbledhjen dhe transportimin e mbetjeve nga prishja e objekteve i përket</p>

Nr	Çështja/konstatimet	Nr. i paragrafit	Komenti/veprimi
	<p>ishin fotografitë ajrore të përdorura për të identifikuar shtëpitë që duheshin prishur. Kjo përbën një mbështetje të drejtpërdrejtë dhe me rëndësi materiale të Projektit për prishjen e objekteve në Jalë. Paneli vëren se ky aktivitet i Projektit nuk pranohej dhe as përshkruhej në Përgjigjen e Grupit të Menaxherëve. Madje, në Përgjigje thuhet, me terma aspak të paqartë, se <i>“prishja e objekteve nuk ka pasur asnjë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me Projektin.”</i></p> <p>Dokumentacioni i Projektit tregon se Projekti ka ofruar burime dhe mbështetje për Policinë e Ndërtimit në lidhje me aktivitetet për prishjen e objekteve në zonën e Projektit. Kjo lloj mbështetjeje konfirmon një lidhje me rëndësi të madhe midis Projektit dhe prishjes së objekteve.</p> <p>Mirëpo, ky përshkrim në Përgjigjen e Grupit të Menaxherëve nuk përfshin elementet e planit të prokurimeve të Projektit, që përfshin sigurimin e pajisjeve të zyrës, orendive dhe automjeteve për kapacitetin e zbatimit me forcë të ligjit dhe pajisjet për mbledhjen dhe transportimin e mbetjeve inerte nga prishja e objekteve. Sikurse theksohet më lart, misioni mbikëqyrës i datës 19-24 shkurt 2007 konfirmonte sigurimin e pajisjeve bazë për Policinë e Ndërtimit nga Projekti. Për më tepër, më 3 prill 2006, Policia e Ndërtimit paraqiti një kërkesë për financimin nga Projekti të automjeteve dhe disa artikujve të pajisjeve elektronike dhe të zyrës.</p> <p>Analiza dhe faktet e konstatuara më lart tregojnë se duhet të ishte aplikuar Politika e Bankës “Për shpërnguljen e detyruar” në rastin e prishjes së objekteve që lidhet me Projektin. Ky përfundim merr në konsideratë asistencën që Projekti i ka dhënë Policisë së Ndërtimit për kryerjen e funksioneve të kësaj të fundit, fotografitë ajrore që identifikojnë shtëpitë e prishura po kështu janë financuar nga Projekti, si edhe komunikimi zyrtar i NJKP-së që i bën thirrje Policisë së Ndërtimit të merret me ndërtimet e pretenduara si të paligjshme.</p> <p>Paneli e gjen të pabazë thënien e Grupit të Menaxherëve se <i>“prishja e objekteve nuk ka pasur lidhje të</i></p>		<p>nën/komponentit të administrimit të mbetjeve të ngurta në bregdetin e jugut. Në DVP thuhet, <i>“Projekti do të financojë një projekt pilot për mbetjet inerte për të ulur sasinë e mbetjeve të përhapura në terren përmes mbledhjes dhe largimit të synuar të mbetjeve inerte në vend-groposje”</i>. Kjo pajisje është përcaktuar për shoqëritë e administrimit të vend-groposjeve të mbeturinave, të cilat do të kenë në administrim vend-groposjet e mbeturinave në bashkitë Sarandë dhe Himarë.</p> <p>VEPRIMI:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shih Pikën 2 për shqyrtimin gjyqësor, Vlerësimin Social dhe të Prekshmërisë dhe ristrukturimin e Projektit. 2. Grupi i Menaxherëve do të shqyrtojë aplikimin e politikave mbrojtëse në rastin e veprimeve të paautorizuara të njësive të koordinimit të projekteve dhe do të përgatisë dhe shpërndajë udhëzime në lidhje me këtë çështje brenda datës 30 qershor 2009. Për punonjësit në të gjitha regjionet do të ofrohet trajnim i synuar, në mbështetje të aplikimit të këtij udhëzuesi. 3. Grupi i Menaxherëve do të vijojë zbatimin Strategjinë e Komunikimit të Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë, Shqipëri, të rishikuar rishtazi. Ndër të tjera, strategjia e re përfshin: (a) një sistem për përgjigje parapritëse dhe me afate kohore kundrejt ankesave të ardhura nga bashkësitë, shoqëria civile dhe sektori privat; (b) seanca vjetore informimi për komisionet përkatëse parlamentare në lidhje me zbatimin e projekteve dhe çështjet e reformave të politikave; dhe (c) rritje të mbikëqyrjes së proceseve të konsultimeve të udhëhequra nga qeveria gjatë përgatitjes dhe zbatimit të projekteve.

Nr	Çështja/konstatimet	Nr. i paragrafit	Komenti/veprimi
	<p><i>drejtpërdrejtë apo të tërthortë me Projektin.</i> Në të vërtetë, Paneli konstaton një lidhje të drejtpërdrejtë midis prishjes së objekteve në Jalë dhe Projektit dhe objektivave të tij. Për rrjedhojë, Paneli konstaton se Grupi i Menaxherëve nuk i ka zbatuar kërkesat e PO/PB 4.12 për shpërnguljen e detyruar në lidhje me prishjen e objekteve që ka ndodhur në Jalë. Në këtë kuptim, Projekti nuk i ka përmbushur as objektivat për uljen e varfërisë të parashtruar në PO 1.00 për uljen e varfërisë.</p>		
9.	<p>Trajtimi i ankesave të banorëve të Jalës. Si pjesë e një "skeme të mirë projekti", në përgatitjen e PZHBJ-së, Grupi i Menaxherëve ra dakord me huamarrësin se do të përpilonte disa kritere dhe procedura të caktuara për të asistuar "personat e prekur që humbasin banesën parësore të tyre ose burimin kryesor të jetesës për shkak të heqjes së objektit zaptues". Megjithatë, Paneli vëren se ky premtime realizohet vetëm me t'u përgatitur PZHBJ-ja. Për rrjedhojë, kjo skemë e Projektit nuk ka mundur ofrimin e asistencës për personat që kanë humbur shtëpitë e tyre apo burimet e jetesës në Jalë. Me atë që mund të konfirmojë Paneli, deri më datën e këtij Raporti, këtyre personave nuk u është dhënë asnjë asistencë.</p>	158	<p>KOMENT: Grupi i Menaxherëve duhet të kishte ngulur këmbë për vendosjen e një moratoriumi mbi veprimtarinë e prishjes së objekteve në zonën e Projektit deri në çastin kur do të përgatiteshin PZHBJ dhe planet vendore përkatëse dhe kur do të vihej në zbatim paketa e masave të mbrojtjes sociale. Projekti nuk duhej t'i ishte paraqitur për miratim Bordit, në mungesë të një moratoriumi për prishjen e ndërtimeve ekzistuese.</p> <p>VEPRIMI:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shih Pikën 2 për shqyrtimin gjyqësor, Vlerësimin Social dhe të Prekshmërisë dhe rristrukturimin e Projektit. 2. Nëse anulohet Kredia, Grupi i Menaxherëve propozon t'u jepet asistencë familjeve të prekura, përfshirë edhe fonde nga burimet e vetë Bankës, nëse është e nevojshme, edhe pse, juridikisht, Banka nuk është e detyruar ta bëjë një gjë të tillë. 3. Grupi i Menaxherëve do t'i raportojë Bordit, pas tre muajsh, në lidhje me asistencën e dhënë personave të prekur nga prishja e objekteve e muajit prill 2007, në rast të anulimit të Kredisë.
10.	<p>Një proces i pjesshëm i mbledhjes së fakteve në përgjigje të ankesave të Kërkuesve</p> <p>Mospërfshirja në raportin për zyrën të Misionit fakt-mbledhës, e ngjarjeve kyçe dhe e marrëdhënieve që lidhen me prishjen e objekteve në Jalë, mund të konsiderohet si keqparaqitje me rëndësi materiale e një situatë për të cilin Misionit i ishte dhënë mandati të siguronte "një njohuri më të plotë të fakteve". Kjo mospërfshirje nuk mund të japë informacionin provues, i cili do të kishte nxjerrë në pah të metat themelore të skemën e Projektit, zbatimin e Projektit dhe mbikëqyrjen e tij. Duket se Grupit të Menaxherëve do t'i ishte shërbyer më mirë, nëse ajo do të kishte dërguar në terren, në këtë mision për mbledhjen e fakteve rreth një situatë tejet të debatueshme, persona të cilët nuk ishin përfshirë drejtpërdrejt në Projekt. Paneli</p>	222-234	<p>KOMENT: Duke mos reaguuar në kohë për prishjen e objekteve të muajit prill 2007, Grupi i Menaxherëve i dha mundësi opinionit publik ta lidhte prishjen e objekteve me Projektin dhe, rrjedhimisht, me Bankën Botërore. Prishja e objekteve në Jalë u bë nga data 17 prill deri më 21 prill 2007. Ekipi i Projektit, për herë të parë, mësoi për këtë aksion nga media më 18 prill 2007 dhe kontaktoi Njësinë shqiptare të Koordinimit të Projektit më 19 prill 2007. Po atë ditë, Ekipit të Projektit i erdhi një kopje e letërkëmbimit të datës 26 mars 2007 midis Njësisë shqiptare të Koordinimit të Projektit dhe Policisë së Ndërtimit. Zonën e vizitoi një "Mision fakt-mbledhës", i përbërë nga Drejtuesi i Ekipit të Projektit dhe Eksperti Social i Ekipit të Projektit, më 3-5 maj 2007. Siç e thekson edhe Paneli i Inspektimit, misioni nuk arriti t'i kalojë Grupit të Menaxherëve informacione me rëndësi kritike, sidomos sa i takon ekzistencën së letërkëmbimit midis Njësisë shqiptare të Koordinimit të Projektit dhe Policisë së Ndërtimit. Duket se Ekipi i Projektit nuk e ka vlerësuar rëndësinë e gjuhës që përmbante letërkëmbimi në fjalë. Pas "Misionit fakt-mbledhës", për disa muaj nuk u tregua asnjë vëmendje për familjet e prekura nga prishja e objekteve e muajit prill 2007. U protokollua një letërkëmbim me Kërkuesit, që i është përcjellë edhe Shefit të Zyrës në Vend dhe Shefit</p>

Nr	Çështja/konstatimet	Nr. i paragrafit	Komenti/veprimi
	<p>konstaton se raporti “fakt-mbledhës” i vetë Grupit të Menaxherëve, duke lënë jashtë fakte thelbësore, të cilat ka detyrimin për t’i raportuar sipas termave të referencës të Misionit, nuk i përmbush kërkesat e Politikës së Bankës për Mbikëqyrjen, PO/PB 13.05.</p>		<p>të Sektorit, por që nuk mori asnjë përgjigje. Stafit drejtues për vendin nuk i korrigoj raportimet e gabuara të medias.</p> <p>Grupi i Menaxherëve është e shqetësuar me lidhjet që bëhen në Raportin e Investigimit të Panelit të Inspektimit, në lidhje me deklaratat e bëra nga zyrtarët qeveritarë në Kuvendin e Shqipërisë në prill 2007 pas prishjes së objekteve. Grupi i Menaxherëve porositi një përkthim të tekstit të zbardhur të komenteve të Ministrit. Grupi i Menaxherëve vëren se të vetmet deklarata që ka bërë Ministri në lidhje me Bankën Botërore janë:</p> <p><i>“Nuk ka asnjë projekt qeveritar për fshatra turistike, pasi tashmë ky është një fakt i njohur publikisht edhe nëpërmjet medias, sepse nuk është përfunduar plani i zonës bregdetare, as qeveria as Banka Botërore nuk financojnë projekte për fshatra turistike. Ky është një fakt botërisht i njohur, aktualisht do të thoja se veçanërisht ju, deputetët e zonës, duhet të jeni në dijeni se Qeveria e Shqipërisë me ndihmën e Bankës Botërore po punojmë për finalizimin e zonës bregdetare, të cilat janë me karakter, me transparencë të plotë, me pjesëmarrjen e njësisë vendore dhe komunitetit të zonës. Për herë të parë, ky projekt i Bankës Botërore parashikon 13 milion USD në investime, rrugë, ujësjellësa, konservim, në ndriçim për të gjithë zonën bregdetare, me një skemë bashkëfinancimi, ku kanë rënë dakord autoritetet lokale për komunitetin, pasi janë komunitetet që bashkëfinancojnë 20% të këtyre projekteve, sepse për t’i hapur rrugë këtyre financimeve ligji duhet të veprojë.”</i></p> <p>VEPRIMI:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shih Pikën 5 për shqyrtimin e llogaridhënies. 2. Shih Pikën 8 për forcimin e komunikimit në Zyrën e Bankës Botërore në Tiranë, Shqipëri. 3. Zyra e Bankës Botërore në Tiranë të Shqipërisë do të kryejë trajnim periodik për stafin e projekteve dhe qeveritarët, në lidhje me aplikimin e politikave të masave mbrojtëse të Bankës Botërore në rastin e projekteve të portofolit në Shqipëri.
SHËNIME PËRMBYLLËSE			
11.	<p>Përfundime</p> <p>Paneli konstaton se vendimi i parë për të mos e aplikuar PO/PB 4.12 në fazën vendimtare të vlerësimit të projektit ka qenë rrënja e shkakut të keqadministrimit nga Grupi i Menaxherëve të situatës së prishjes së objekteve në Jalë. Paneli konstaton se, jo vetëm gjatë ndërtimit dhe vlerësimit të Projektit, por edhe gjatë zbatimit të Projektit, Banka nuk i ka zbatuar kërkesat e politikës së saj PO/PB 4.12 për shpërnguljen e detyruar.</p> <p>Ky Projekt, që përfshinte komponentë të cilët dihet se kanë të bëjnë me prishjen e objekteve në zonën e</p>	243-248	<p>KOMENT: Grupi i Menaxherëve ndjen keqardhje të thellë për ngjarjet që kanë ndodhur në prill 2007 në bregdetin e jugut. Janë bërë një sërë gabimesh gjatë gjithë ciklit të Projektit, përfshirë fazat e përgatitjes së Projektit, paraqitjes përpara Bordit dhe mbikëqyrjes së Projektit, si edhe gjatë përgatitjes së Përgjigjes së parë të Grupit të Menaxherëve, në shtator 2007, dhe gjatë nxjerrjes së Ndrejjes së Gabimeve në Dokumentin e Vlerësimit të Projektit, në shtator 2008. Këto gabime janë të papranueshme dhe nxjerrin në pah një mosfunksionim të rëndë të mekanizmave të llogaridhënies, përgjegjësisë dhe kontrollit mbikëqyrës që ushtron mbi Projektin Grupi i Menaxherëve. Grupi i Menaxherëve i është mirënjohëse Panelit të Inspektimit, për faktin që ia ka sjellë në vëmendje këto gabime, dhe pajtohet me Panelin se janë shkelur PO/PB 10.00 “Për huadhënien për investime—nga identifikimi deri në paraqitjen përpara Bordit” dhe PO/PB</p>

Nr	Çështja/konstatimet	Nr. i paragrafit	Komenti/veprimi
	<p>Projektit, mbante brenda tij një rrezik me rëndësi kritike, i cili mund të ishte evituar përmes një kuadri të përshtatshëm kontraktor dhe përmes mbikëqyrjes adekuate. Paneli konstaton se Banka nuk ia ka dalë mbanë ta mbikëqyrë Projektin, siç ia kërkon Politika e Bankës për mbikëqyrjen PO/PB 13.05.</p> <p>Paneli arrin edhe në përfundimin se Përgjigjja e Grupit të Menaxherëve nuk ka ndihmuar dhe nuk ka qenë informative dhe, në disa vende, binte tërësisht ndesh me informacionin faktik, të cilin Grupi i Menaxherëve kishte kohë që e dinte.</p>		<p>13.05 “Për mbikëqyrjen e projekteve”.</p> <p>Në lidhje me PO/PB 4.12, shih Pikat 1-4, më lart.</p> <p>VEPRIMI:</p> <p>1. Shih Pikën 9 për Raportin e Grupit të Menaxherëve për Bordin.</p>